



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 260 Akti**

**Nr. 228 Vendimi  
Tiranë, më 17.1.2020**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko      Kryesuese  
Etleda Çiftja      Relatore  
Xhensila Pine      Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, në datën 13.1.2020, ora 10:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:**      **Znj. Marsela Balili**, gjyqtare në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

**OBJEKTI:**      **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:**      **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet Ç, D, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

## **KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Marsela Balili, dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, e cila në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë të subjektit, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT PROCEDURALE**

1. Znj. Marsela Balili është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, në momentin e shortimit, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar” dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Znj. Marsela Balili, bazuar në nenin 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit duke u shortuar në datën 15.1.2019, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët: Pamela Qirko, Etleda Çiftja dhe Xhensila Pine.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 – 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) sipas neneve 34 – 39, të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin nr. 1, datë 22.1.2019, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues, komisioneren Pamela Qirko. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, në datën 17.12.2019, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, znj. Marsela Balili, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar bashkë me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 – 47 dhe 35 – 40, të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarinimin e

konfliktit të interesit, me të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

6. Në datën 18.12.2019, përmes postës elektronik<sup>1</sup>, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda datës 6.1.2020; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 – 47 dhe 35 – 40, të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 6.1.2020, subjekti i rivlerësimit, përmes postës elektronike<sup>2</sup> dhe fizikisht, paraqiti shpjegimet së bashku me provat e reja në mbështetje të barrës së provës, kaluar me relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht, bashkë me dokumentacionin dërguar gjatë hetimit sipas formës së kërkuar nga ligji.

8. Në vendimin nr. 3, datë 9.1.2020, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Marsela Balili, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u njoftua përmes postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 13.1.2020, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, kati 0, Tiranë.

9. Në datën 13.1.2020, ora 10:30, u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit.

10. Bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016: *“Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave.”*, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin Marsela Balili, vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke mos vendosur mbi kriterin e vlerësimit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional.

11. Për shmangien e çdo keqinterpretimi, ky vendim, mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit për znj. Marsela Balili, merret vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kjo nuk përbën gjë të gjykuar (*res judicata*) për kriterin e vlerësimit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

12. Në datën 13.1.2020 u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit, si dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë.

13. Subjekti i rivlerësimit paraqiti dy kërkesa paraprake gjatë seancës dëgjimore: kërkesa e parë konsistoi në lidhje me administrimin e provave të reja, kërkesë e cila u pranua nga trupi gjykues; kërkesa e dytë konsistonte në rihapjen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera, kontrolli i figurës dhe i vlerësimit profesional. Kërkesa e dytë nuk u pranua nga trupi gjykues.

---

<sup>1</sup> *E-mail*, datë 18.12.2019, ora 10:09, “Komisioni – njoftim për mbylljen e hetimit kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit”.  
<sup>2</sup> *E-mail* datë 6.1.2020, ora 13:32, në përgjigje të *e-mail*-it “Komisioni – njoftim për mbylljen e hetimit kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit”.

14. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryera mbi kriterin e pasurisë dhe të kaluara te subjekti si barrë prove për shpjegime.

15. Znj. Marsela Balili shprehu qëndrimin e saj pasi dëgjoi relacionin, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Subjekti, gjithashtu, depozitoi gjatë seancës dëgjimore prova të reja<sup>3</sup>, të cilat u administruan nga trupi gjykues në këtë seancë për një vlerësim, para marrjes së vendimit përfundimtar.

16. Në seancën dëgjimore të datës 13.1.2020, subjekti i rivlerësimit, znj. Marsela Balili, kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca për pretendimin e subjektit u shty për në datën 17.1.2020.

17. Në përfundim të seancës së datës 17.1.2020, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi ta konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin, znj. Marsela Balili, duke u bazuar vetëm në kriterin e pasurisë dhe shpalli vendimin për procesin e rivlerësimit.

### **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

18. Subjekti i rivlerësimit, znj. Marsela Balili, ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit në përputhje me nenin 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

19. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”:

- i. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror.
- ii. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit.
- iii. Këshilli i Lartë i Drejtësisë (tashmë Gjyqësor) është organi përkatës i vlerësimit profesional, i cili përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pasi përfundon

---

<sup>3</sup> Shkresë nr. \*\*\*, (1 fletë), datë 31.12.2019, e Bashkisë Tiranë; vërtetim nr. \*\*\*, (1 fletë), datë 24.12.2019; apostile dokumente (4 fletë); “\*\*\*\*” – llogari kursimi (1 fletë); kërkesë, (1 fletë), datë 26.12.2019, drejtuar Arkivit të Sigurimeve Shoqërore, Lundër Tiranë; shënime dore (2 fletë), “lindja e A.”.

shqyrtimi i dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe përzgjedhja e pesë dokumenteve sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

20. Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>4</sup>, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

## **V. RIVLERËSIMI I PASURISË**

### **V/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

21. ILDKPKI-ja, me raportin nr. \*\*\*, datë 13.7.2018, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Marsela Balili, e cila është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me nr. indeksi \*\*\* dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

22. Subjekti ka dorëzuar deklaratat e interesave private për vitet 2003 – 2016 dhe në datën 28.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016 ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, “Vetting”. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur, është konstatuar:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

### **V/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

23. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”, të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2003 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit

---

<sup>4</sup> Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2, të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1, të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, e në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

24. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar në pikën 5, të nenit 33, ligjit nr. 84/2016.

### **Personat e lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit që janë hetuar**

25. Për efekt të procesit të rivlerësimit personat që janë hetuar si të lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit janë: (1) z. A.P. konsiderohet person i lidhur për shkak se është bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe është i përfshirë në certifikatën familjare; (2) z. P. dhe znj. V.B. (prindërit) konsiderohen persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, si rezultat i dhënies së ndihmës financiare për mobilimin e apartamentit me sip. 72.5 m<sup>2</sup>, në Tiranë, dhënies në përdorim e apartamentit të blerë me kontratën paraprake nr. \*\*\*, datë 9.1.2017, në Vlorë; administratore e llogarive bankare në emër të tyre; ndihmesa në të holla për përballimin e jetesës; (3) z. M.M., konsiderohet person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, si rezultat i dhënies së huas në shumën 40.000 euro; (4) znj. Zh.S.M. (tezja e bashkëshortit) konsiderohet person tjetër i lidhur, pasi ka paguar pushimet e subjektit të rivlerësimit në vlerën 2.800 euro, në Korfuz Greqi.

### **V/3 Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruar në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting” të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur**

#### **1. Apartament *duplex*, me sip. 196.5 m<sup>2</sup>, i ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë**

**1.1** Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron apartamente banimi me sip. 101.5 m<sup>2</sup> dhe sip. 95 m<sup>2</sup>, blerë sipas kontratave nr. \*\*\*, datë 25.6.2012 dhe nr. \*\*\*, datë 25.6.2012. Vlera: 125.000 euro. Pjesa takuese: 50 %.

**1.2** Si burim krijimi subjekti deklaron: kredi bankare në vlerën 40.000 euro, sipas kontratës bankare nr. \*\*\*, datë 18.10.2007; vlerën 61.000 euro, të përfituar nga shitja e apartamentit të mëparshëm të banimit, sipas kontratë shitjes nr. \*\*\*, datë 26.9.2012; vlerën 14.000 euro, të shlyer nga shuma e marrë hua në vitin 2011 nga shtetasi M.M. për qëllim të hapjes së një aktiviteti fitimprurës nga bashkëshorti, por që u përdor për banesën; dhe vlera prej 10.000 euro e mbetur e pashlyer sipas kontratës së huas nr. \*\*\*, datë. 25.6.2012. Për vërtetimin e deklarimeve subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues<sup>5</sup>.

---

<sup>5</sup>Kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme me nr. \*\*\*, datë 25.6.2012, palë shitëse shoqëria ndërtimore “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe palë blerëse, shtetasi A.P., me objekt shitjen e një apartamenti me sip. 95 m<sup>2</sup> (tip *duplex*, pjesa e sipërme), Çmimi i blerjes është 7.590.000 lekë. Bashkëlidhur kontratës: vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. \*\*\*, datë 5.4.2012; hartë treguese e pasurisë; plan vendosje e apartamentit; kartë identiteti të palëve dhe certifikatë familjare; kartelë e pasurisë së paluajtshme për

**1.3** Në lidhje me përputhshmërinë e deklaramit të dokumentacionit të administruar nga ZVRPP-ja Tiranë<sup>6</sup>, konfirmohet se në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, personit tjetër të lidhur, z. A.P., është regjistruar pasuria e llojit apartament me sip. 95 m<sup>2</sup> nr. \*\*\*, vol \*\*\*, f. \*\*\* dhe me sip. 101.5 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, vol \*\*\*, f. \*\*\*, i ndodhur në z. k. \*\*\*.

**1.4** Nga sa më lart, Komisioni konstaton se deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit.

#### **Nga hetimi i Komisionit konstatohet se:**

**1.5** Sipas dokumentacionit të administruar nga ZVRPP-ja Tiranë dhe kontratave të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting”, apartamenti është blerë me kontratat e shitjes së pasurisë së paluajtshme si: (a) kontrata nr. \*\*\*, datë 25.6.2012, me palë shitëse shoqërinë ndërtimore “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe palë blerëse personin tjetër të lidhur, z. A.P., me objekt shitjen e një apartamenti (tip *duplex*, pjesa e sipërme) sip. 95 m<sup>2</sup>, k. \*\*\*, objekti \*\*\*, nr. \*\*\*, nr. pasurie \*\*\*, në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë. Çmimi i blerjes është 7.590.000 lekë (shuma ekuivalente 55.000 euro), shumë të cilën blerësi e ka likuiduar tërësisht me këste; (b) kontrata nr. \*\*\*, datë 25.6.2012, me palë shitëse shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe palë blerëse personin tjetër të lidhur, z. A.P., me objekt shitjen e një apartamenti (tip *duplex*, pjesa e ndenjes, shkallës dhe tualetit), me sip. 101.5 m<sup>2</sup>, k. \*\*\*, objekti \*\*\*, nr. \*\*\*, nr. pasurie \*\*\*, në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë. Çmimi i blerjes është 9.960.000 lekë (shuma ekuivalente 70.000 euro), shumë të cilën blerësi e ka likuiduar tërësisht me këste.

**1.6** Vërtetuar me kartelën e pasurisë së paluajtshme për apartamentin me sip. 95 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\* dhe kartelën për apartamentin me sip. 101.50 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, në pronësi të shtetasit A.P.

**1.7** Prej hetimit të kryer nga Komisioni rezultoi se shoqëria ndërtimore “\*\*\*\*” sh.p.k.,<sup>7</sup> ka lidhur një “aktmarrëveshje” me personin tjetër të lidhur, z. A.P., në datën 12.12.2007, me objekt: “shoqëria merr përsipër të ndërtojë një apartament *duplex* me sip. të përgjithshme 197 m<sup>2</sup>, nga të cilat 175 m<sup>2</sup> funksionale dhe 22 m<sup>2</sup> sip. e përbashkët. Me vërtetimin noterial nr. \*\*\* rep., datë 12.12.2007, noterja E.T., vërteton se palët nënshkruan në praninë e saj aktmarrëveshjen dhe vërteton nënshkrimin e tyre në bazë të ligjit për noterinë.

Sipas kësaj kontrate, vlera e plotë e apartamentit është 130.000 euro, personi tjetër i lidhur z. A.P., do të paguajë: (i) vlerën 40.000 euro me hartimin e kësaj kontrate; (ii) vlerën 80.000

---

apartamentin me sip. 95 m<sup>2</sup>; kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme me nr. \*\*\*, datë 25.6.2012, me objekt shitjen e një apartamenti me sip. 101.5 m<sup>2</sup> (tip *duplex*, pjesa e ndenjes, shkallës dhe tualeti), çmimi i blerjes është 9.960.000 lekë. Bashkëlidhur kontratës: vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. \*\*\*, datë 5.4.2012; harta treguese; plan vendosje e apartamentit; kartë identiteti dhe certifikatë familjare; kartelë e pasurisë së paluajtshme për apartamentin me sip. 101.50 m<sup>2</sup>; kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme me nr. \*\*\*, datë 26.9.2012. Bashkëlidhur kontratës: vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. \*\*\*, datë 12.12.2002 dhe hartë treguese; vërtetim, datë 27.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”, bashkëlidhur planpagesat e kredisë; kontratë kredie bankare dhe hipoteke nr. \*\*\*, datë 18.10.2007. Bashkëlidhur kontratës: vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. \*\*\*, datë 12.12.2002; hartë treguese; kontratë hipotekë nr. \*\*\*, datë 23.8.2012, midis “Raiffeisen Bank” dhe palës hipotekuese, shtetasve A.P. dhe Marsela Balili, për shumën 40.000 euro, të përfituar në vitin 2007, e cila do të ketë si kolateral vendosjen në hipotekë në favor të bankës, apartamentin me sip. 101.5 m<sup>2</sup>, në Rr. “\*\*\*\*”. Bashkëlidhur kontratës: vërtetim nga dokumentet hipotekore nr. \*\*\*, datë 7.8.2012 dhe nr. \*\*\*, datë 7.8.2012; harta treguese; kartat e identitetit të palëve dhe certifikatë familjare; kontratë huaje nr. \*\*\*, datë 25.6.2012.

<sup>6</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.8.2019, praktika bashkëlidhur.

<sup>7</sup> Shkresë nr. \*\*\*, datë 23.10.2019.

euro deri në dhjetor të vitit 2009; dhe (iii) diferenca prej 10.000 euro do të paguhet me dorëzimin dhe hipotekimin e apartamentit deri në maj të vitit 2010.

**1.8** Nga analizimi i këtij dokumentacioni krahasuar me kontratat e shitjes së apartamentit, rezulton se aktmarrëveshja e nënshkruar në vitin 2007, nuk përmban të njëjtat elemente me ato të kontratave të shitjes, për sa i përket sipërfaqes dhe çmimit.

**1.9** Nga analizimi i deklaratave periodike vjetore, të administruara nga ILDKPKI-ja, si dhe akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit, znj. Marsela Balili, rezultoi se mungojnë deklaratat periodike vjetore të viteve 2011<sup>8</sup>( rezulton vetëm deklarata periodike vjetore e vitit 2011, e largimit nga funksioni), 2012 dhe 2013, dhe për këtë arsye nuk janë marrë në konsideratë nga ILDKPKI-ja në përgatitjen e raportit përfundimtar.

**1.10** Nisur nga ky fakt, Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit për një hetim të thellë dhe të gjithanshëm, me pyetësonin nr. 1<sup>9</sup>, si dhe ILDKPKI-së<sup>10</sup> të paraqesë në Komision deklaratat që mungojnë.

**1.11** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësonit nr. 1<sup>11</sup>, ka vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacionin ligjor justifikues në lidhje me dorëzimin e deklaratave periodike vjetore të viteve 2011 – 2012, në ILDKPKI<sup>12</sup> dhe ka depozituar deklaratën periodike vjetore të vitit 2013.

**1.12** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, rezulton e deklaruar: (i) apartamenti i banimit me sip. 72.5 m<sup>2</sup>, i deklaruar në deklarimin e parë të pasurisë, i shitur sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 26.9.2012, në vlerën 61.000 euro; (ii) sipas kontratave të shitjes nr. \*\*\*, dhe nr. \*\*\*, datë 25.6.2012, është blerë banesë tjetër, në vlerën 125.000 euro. Pjesa takuese: 50 %. Subjekti deklaron si burim krijimi për blerjen e këtij apartamenti të njëjtin burim me atë të deklaruar në deklaratën “Vetting” (të shënuar më sipër); (iii) subjekti ka deklaruar në seksionin e të dhënave konfidenciale, shpenzime për rregullime dhe mobilim për shtëpinë e banimit në vlerën 22.000 euro. Dokumente justifikues nuk ka. Burimi: shuma e marrë hua prej shtetasit M.M.

**1.13** Komisioni, nga dokumentacioni i administruar nga ILDKPKI<sup>13</sup>-ja, informohet se pas një kontrolli elektronik dhe fizik në protokoll-arkivën e ILDKPKI-së, nuk u gjend deklarata periodike e vitit 2012, për të cilën është bashkëlidhur vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 5.4.2013. Sipas ILDKPKI-së punonjësja e cila e ka marrë në dorëzim këtë deklaratë nuk punon më në këtë institucion. Deklarata periodike vjetore e vitit 2013 rezulton e dorëzuar në ILDKPKI, nëpërmjet shkresës nr. \*\*\* prot., datë 14.4.2014, deklaratë të cilën ILDKPKI-ja e ka vënë në dispozicion të Komisionit.

<sup>8</sup> Për vitin 2011 disponohet vetëm deklarata e largimit nga funksioni, e dorëzuar në datën 20.3.2011.

<sup>9</sup> Dërguar në datën 24.10.2019.

<sup>10</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2019, e Komisionit.

<sup>11</sup> E-mail i datës 25.10.2019.

<sup>12</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.5.2012, e ILDKPKI-së, kthim përgjigjeje datë 11.05.2012, drejtuar ILDKPKI-së dhe vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 11.5.2012, lëshuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 22.5.2012, e ILDKPKI-së (bashkëngjitur zarfi postar); vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 1.6.2012, lëshuar nga ILDKPKI-ja për marrjen në dorëzim të deklarimit të pasurisë për vitin 2011 dhe shkresë datë 31.5.2012, drejtuar ILDKPKI-së dhe deklaratë e interesave private pas largimit nga funksioni. Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 5.4.2013, lëshuar nga ILDKPKI-ja për marrjen në dorëzim të deklarimit të pasurisë për vitin 2012 dhe shkresë datë 3.3.2013, drejtuar ILDKPKI-së dhe deklaratë e interesave private periodike vjetore (data e dorëzimit të deklaratës 30.3.2014).

<sup>13</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.11.2019.



**1.14** Komisioni, nga analizimi i raportit të hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI, si dhe duke marrë në konsideratë dokumentacionin e administruar nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk i ka fshehur apartamentet me sip. 101.5 m<sup>2</sup> dhe sip. 95 m<sup>2</sup>, me vlerë totale 125.000 euro, të ndodhur në Tiranë, në deklaratimet e interesave private të vitit 2012, sikundër konkludon ILDKPKI-ja në raportin e saj.

**1.15** Më qëllim analizimin e vlerës së blerjes së këtij apartamenti dhe nëse ka pasur apo jo ndonjë trajtim preferencial për subjektin, sipas udhëzimit nr. 2, datë 4.4.2007, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, dhe të koeficientit ‘k’, për vitin 2007”, rezulton se vlera reale e tregut për këtë apartament përlllogaritet në shumën 19.060.500 lekë (196.5 m<sup>2</sup> x 97.000 lekë/m<sup>2</sup>), ndërkohë që ky apartament është blerë në shumën 17.550.000 lekë. Referuar kostos së ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave, ky apartament është blerë 1.510.500 lekë, më lirë se vlera e tregut.

**1.16** Komisioni i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, për të hetuar nëse subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit me shitësit/ndërtuesit e këtij apartamenti. Nga hetimi i dokumentacionit të administruar nga kjo gjykatë<sup>14</sup>, nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit me shitësit/ndërtuesit e këtij apartamenti.

**1.17** Nga faktet e analizuarra më lart, bazuar në nenin 52, të ligjit 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, për sa vijon: (i) ka mospërputhje në lidhje me blerjen dhe kryerjen e pagesave të këtij apartamenti midis deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting” dhe dokumentacionit të administruar nga shoqëria e ndërtimit “\*\*\*\*” sh.p.k., për shkak se: (1) në deklaratën “Vetting” subjekti deklaroi se zotëron apartamente banimi me sip. 101.5 m<sup>2</sup> dhe sip. 95 m<sup>2</sup>, me vlerë 125.000 euro, blerë sipas kontratave nr. \*\*\*, datë 25.6.2012 dhe nr. \*\*\*, datë 25.6.2012; (2) ndërkohë nga dokumentacioni i administruar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka porositur me anë të aktmarrëveshjes këtë apartament me vlerë 130.000 euro, në datën 12.12.2007; (ii) subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, z. A.P., nuk kanë deklaruar porositjen me aktmarrëveshje të këtij apartamenti me sip. 197 m<sup>2</sup>, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007; (iii) duke mos deklaruar këtë apartament në vitin 2007, subjekti, gjithashtu nuk ka deklaruar ndër vite pagesën e kësteve si më poshtë: (1) vlerën 40.000 euro me hartimin e kësaj kontrate (datë 12.12.2007); (2) vlerën 80.000 euro deri në dhjetor të vitit 2009; dhe (3) diferenca prej 10.000 euro do të paguhet me dorëzimin dhe hipotekimin e apartamentit deri në maj të vitit 2010; (iv) Duket se ky apartament është blerë në vlerën 1.510.500 lekë, më lirë se vlera e tregut të parashikuar në udhëzimin nr. 2, datë 4.4.2007, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, dhe të koeficientit ‘k’, për vitin 2007”.

**1.18** Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, sipas pikës 1.17 më lart, dërgoi shpjegime dhe prova për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, si vijon:

---

<sup>14</sup> Shkresë nr. \*\*\*, datë 3.12.2019.

(i) Aktmarrëveshja, datë 12.12.2007, e lidhur me shoqërinë ndërtimore “\*\*\*\*” sh.p.k., nuk është deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, për arsye se me lidhjen e saj pasuria e paluajtshme nuk pësoi ndryshim. Nëse aktmarrëveshja finalizohet, atëherë pasuria pëson ndryshim dhe duhet të deklarohet. Në deklaratat periodike vjetore kërkohen shtesat apo pakësimet në pasurinë e paluajtshme apo të luajtshme dhe, kur pasuria e paluajtshme pësoi ndryshim me lidhjen e kontratave të shitjes nr. \*\*\*, dhe nr. \*\*\*, datë 25.6.2012, me të cilat u fitua pronësia, atëherë u deklarua ndryshimi që pësoi pasuria e paluajtshme në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012. (ii) Mbi konstatimin se nuk ka deklaruar ndër vite pagesën e kësteve deklaroi: (1) në deklaratimet vjetore është pasqyruar akordimi nga “Raiffeisen Bank” i kredisë bankare prej 40.000 euro, të cilën e ka marrë me qëllim zgjerim banese, duke paguar këstin e parë prej 40.000 euro, të parashikuar në aktmarrëveshjen datë 12.12.2007; (2) kësti tjetër prej 80.000 euro u parashikua në aktmarrëveshje që të paguhej deri në dhjetor të vitit 2009, duke menduar se në këtë vlerë do të shitej apartamenti i banimit me sip. 72.5 m<sup>2</sup>, i cili u shit në një vlerë më të ulët tri vite më vonë nga parashikimi; (3) diferenca prej 10.000 euro, e parashikuar në aktmarrëveshje, nuk u pagua as në vlerë dhe as në kohë. Në bisedime me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., subjekti kishte rënë dakord që apartamenti *duplex* të shitej në vlerën përfundimtare prej 125.000 euro (me punime të brendshme të papërfunduara), nëse paguhej pjesa tjetër, duke lënë pa paguar vetëm vlerën 10.000 euro, hua shoqërisë. (iii) Mbi konstatimin se vlera e blerjes ka rezultuar 1.510.500 lekë, më lirë se vlera e tregut, subjekti deklaroi se çmimi për m<sup>2</sup> është caktuar nga kompania ndërtuese dhe përcaktimi i çmimit të shitjes mbetet përgjegjësi e saj. (iv) Lidhur me konstatimet nga hetimi administrativ se aktmarrëveshja e nënshkruar në vitin 2007, nuk përmban të njëjtat elemente me ato të kontratave të shitjes, për sa i përket sipërfaqes dhe çmimit, subjekti shpjegoi se: *“Aktmarrëveshja e lidhur në datën 12.12.2007, për vlerën 130.000 euro, e parashikuar për t’u finalizuar në vitin 2010, në të vërtetë u finalizua në vitin 2012 dhe në vlerë 5.000 euro më të ulët nga parashikimi, pra, 125.000 euro”*. Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., deklaroi se në kontratën e porosisë dhe në kontratat e shitjes nuk ka mospërputhje në sipërfaqe, pasi shkallët dhe pjesët e përbashkëta në kontratën e porosisë janë funksionale dhe të hipotekuara në kontratat e shitjes. Subjekti, në cilësinë e provës, paraqiti shkresën e datës 3.1.2020, lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**1.19** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, “Vetting”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, arsyeton se:

**1.20** Lidhur me mospërputhjet për blerjen dhe kryerjen e pagesave të apartamentit, subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm mospërputhjet që ekzistonin në aktmarrëveshjen e nënshkruar në vitin 2007 dhe kontratave të shitjes në vitin 2012, lidhur me sipërfaqen dhe çmimin e tregut për apartamentin *duplex*.

**1.21** Në lidhje me mosdeklarimin e porositjes së këtij apartamenti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 e në vijim, Komisioni çmon se shpjegimet e subjektit në lidhje me këtë mosdeklarim nuk qëndrojnë, për shkak se subjekti i rivlerësimit duhet të kishte deklaruar në

deklaratën e interesave private periodike si aktmarrëveshjen edhe këstin e parë të paguar nga kredia.

Referuar gurmës “dh”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit mbart detyrimin të deklarojë detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë. Në seksionin “detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, f. 5, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, subjekti ka pasur detyrimin ligjor të deklaronte pagesën e këstit të parë prej 40.000 euro për blerjen e apartamentit *duplex* dhe detyrimet e mbetura ndaj shoqërisë ndërtimore “\*\*\*” sh.p.k., detyrim të cilin nuk e ka zbatuar. Në këtë seksion përcaktohet qartë qëllimi i detyrimit financiar, shuma totale, data e fillimit dhe e mbarimit të detyrimit, shuma e shlyer deri në datën e largimit nga funksioni dhe gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer.

**1.22** Gjithashtu, në deklaratat periodike vjetore për vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2011 (për vitin 2011 zotërohet vetëm deklarimi pas largimit nga funksioni, plotësuar deri në datën 20.3.2011), subjekti nuk ka deklaruar detyrimin e mbetur në vazhdimësi ndaj shoqërisë ndërtimore “\*\*\*” sh.p.k.

**1.23** Komisioni, në lidhje me mosdeklarimin e kësteve të pagesës së apartamentit sipas aktmarrëveshjes, vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit janë deklarative dhe të paprovuara me dokumentacion ligjor provues. Subjekti do të duhej të kishte deklaruar si fillim aktmarrëveshjen në vitin 2007, dhe më tej, çdo ndryshim që përbën shtesë apo pakësim të vlerës së kësaj aktmarrëveshjeje. Ky detyrim është i parashikuar në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003.

**1.24** Në konkluzion të sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, interesat private ndër vite në lidhje me apartamentin e porositur, këstin e parë të paguar dhe kredinë e përdorur për pagimin e këstit të parë.

## **Në lidhje me analizimin e mjaftueshmërisë dhe ligjshmërisë së burimit të krijimit**

### **Burimi I – Lidhur me kredinë bankare në vlerën 40.000 euro, në “Raiffeisen Bank”**

**1.25** Bazuar në dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”<sup>15</sup>, konfirmohet marrja e kredisë me kontratën nr. \*\*\*, datë 18.10.2007, në shumën 40.000 euro, me palë subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin. Kjo kredi është akorduar për një afat 300-mujor. Si kolateral për garantimin e marrjes së kësaj kredie, subjekti ka vendosur një apartament me sip. 72.5 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, në Rr. “\*\*\*”, në pronësi të subjektit dhe personit tjetër të lidhur, z. A.P. Kredia është *disbursuar* në datën 30.7.2007 dhe subjekti i rivlerësimit ka kryer një tërheqje *cash* në datën 31.7.2007, në shumën 39.470 euro.

**1.26** Qëllimi i dhënies së kredisë sipas kontratës është për blerje apartamenti, ndërkohë që në deklaratën vjetore të interesave private të vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo kredi është marrë për zgjerim banese. Bazuar në analizimin e dokumentacionit të administruar nga “Raiffeisen Bank” rezulton se nga personi tjetër i lidhur, z. A.P., është lidhur një kontratë sipërmarrjeje (porosie) nr. \*\*\* prot., datë 27.9.2007, me sipërmarrës shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k.,

<sup>15</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 5.8.2019.

me objekt blerje apartament banimi (3+1), me sip. totale 128.2 m<sup>2</sup>, me adresë: seksioni \*\*\*, k. \*\*\*, pozicioni lindje, nr. \*\*\*, Yzberisht, \*\*\* (\*\*\*), Tiranë, me vlerën 64.000 euro.

**1.27** Referuar kësaj kontrate, citohet se kësti i parë në vlerën 10.000 euro, do të likuidohet në momentin e firmosjes së kësaj kontrate. Kësti i dytë, në vlerën 50.000 euro, do të likuidohet deri në datën 10.11.2007. Kësti i tretë, prej 4.000 euro, nga pjesa e mbetur do të paguhet në momentin e dorëzimit të apartamentit.

**1.28** Komisioni kërkoi informacion të mëtejshëm në “Raiffeisen Bank”, lidhur me aplikimin dhe analizën e riskut për këtë kredi. Në formularët e dërguar nga banka, në përgjigje<sup>16</sup>, ndër të tjera, citohet se: *“Kredia do të financojë blerjen e një apartamenti në ndërtim. Financimi përbën 62.5 % të çmimi të blerjes”*.

**1.29** Më tej, Komisioni me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.10.2019, drejtuar shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., kërkoi informacion shoqëruar me dokumentacion (kontratë porosie/sipërmarrjeje/shitjeje paraprake/kontratë shitblerjeje, dokumentacion justifikues ligjor që vërteton pagesat e kryera etj.), në lidhje me objektin e kontratës së apartamentit (përshkruar më sipër).

**1.30** Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. në përgjigjen e saj<sup>17</sup> na bën me dije se sipërfaqja e apartamentit \*\*\* është ndarë në dy planimetri: ap. \*\*\*, me sip. totale 74.04 m<sup>2</sup>; dhe ap. \*\*\*, me sip. totale 101.32 m<sup>2</sup> (pjesa e mbetur nga ndarja e ap. \*\*\*, i është bashkëngjitur ap. \*\*\*).

Për apartamentin \*\*\*, shoqëria ka lidhur kontratën e shkëmbimit nr. \*\*\*, datë 29.5.2015, me pronarin e truallit, z. G.D., ndërsa për apartamentin \*\*\* është lidhur kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 31.12.2014, me blerës z. A.M.

**1.31** Më tej, në përgjigje të kërkesës së Komisionit për kontratat e porosisë të lidhura përpara ndarjes së apartamentit, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., ka dorëzuar kontratë sipërmarrjeje (porosie) datë 30.10.2007, me porositës shtetasen D.D., dhe zgjidhjen e kontratës së sipërmarrjejes nr. \*\*\*, datë 29.1.2008.

**1.32** Pas analizimit të dokumentacioni të administruar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., rezulton se për të njëjtin apartament të porositur me kontratën e lidhur në datën 29.9.2007, midis personit të lidhur, z. A.P. dhe shoqërisë e cila në datën 30.10.2007 ka lidhur një kontratë tjetër porosie me shtetasen D.D., po për të njëjtin apartament, por, pa revokuar më parë kontratën me personin e lidhur, z. A.P.

**1.33** Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë paraqitur dokumentacion për revokimin e kësaj kontrate.

**1.34** Në lidhje me kolateralin e vendosur për të marrë këtë kredi, pra, apartamentin me sip. 72.5 m<sup>2</sup>, në datën 23.8.2012, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti, e kanë ndryshuar këtë kolateral, duke vendosur tashmë si kolateral të kredisë, apartamentin me sip. 101.5 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë. Apartamenti i mëparshëm i vendosur si kolateral do të shitej dhe hiqej nga barra hipotekore.

<sup>16</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2009.

<sup>17</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2019.

**1.35** Në lidhje me po të njëjtën kredi, bazuar në dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”<sup>18</sup>, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi tjetër i lidhur, z. A.P., kanë lidhur kontratë kredie bankare dhe hipoteke nr. \*\*\*, datë 20.5.2016, me “Raiffeisen Bank”, me objekt kredinë në vlerën 34.358,91 euro, me qëllim mbylljen e detyrimeve të papaguara të kredimarrëses, me afat 300 muaj. Bazuar në analizimin e dokumentacionit të administruar konstatohet se në datën 7.7.2016 është kryer *disbursimi* i kredisë së datës 20.5.2016 (kredia e dytë për ristrukturim), dhe në datën 8.7.2016 është paguar plotësisht detyrimi i mbetur i kredisë së datës 18.10.2007 (kredia e parë).

**1.36** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, subjekti ka deklaruar: “*Kredia bankare e pasqyruar në deklaratimet e mëparshme është ristrukturuar në marrëdhënie me bankën dhe deri në datën 27.1.2017, ka mbetur e pashlyer shuma 34.032,56 euro*”.

**1.37** Nisur nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52, të ligjit 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, për sa vijon: **(i)** mungon dokumentacioni ligjor justifikues (mandatarkëtimi/transfertë bankare), për mënyrën e kryerjes së pagesës së këstit me fondet e tërhequra nga kredia; **(ii)** duket se kjo kredi është marrë për blerjen e apartamentit të porositur në shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., (sipas dokumentacionit të administruar nga banka) dhe jo për zgjerim banese sikundër ka deklaruar subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007; **(iii)** apartamenti i porositur te shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., në vitin 2007, nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur, z. A.P., në deklaratat periodike vjetore ndër vite në ILDKPKI për vitin 2007 e në vijim; **(iv)** mungon dokumentacioni ligjor provues në lidhje me revokimin e kontratës së sipërmarrjes për apartamentin e porositur te shoqëria “\*\*\*” sh.p.k.

**1.38 Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, sipas pikës 1.37 më lart, dërgoi shpjegime dhe prova për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, sa vijon:**

**(i)** Pasi është *disbursuar*, kredia bankare në shumën 40.000 euro, i është paguar shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., jo nëpërmjet bankës, por duke ia dorëzuar fizikisht në zyrën e financës së shoqërisë; **(ii)** kontrata e sipërmarrjes (porosisë) nr. \*\*\* prot., datë 27.9.2007, me sipërmarrës shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., dhe porositës personin e lidhur, z. A.P., nuk ka prodhuar pasoja juridike për palët. Qëllimi i hartimit të kontratës ka qenë për të bërë të mundur tërheqjen/*disbursimin* e kredisë bankare prej 40.000 euro në “Raiffeisen Bank”; **(iii)** një muaj më pas, me kontratën e sipërmarrjes së datës 30.10.2007, apartamenti i porositur i është dhënë një shtetasi tjetër. Në këtë mënyrë, kontrata e sipërmarrjes datë 27.9.2007, ka rënë pa qenë e nevojshme të hartohet një kontratë revokimi. Meqenëse ishte një kontratë e paqenë, që nuk ka prodhuar pasoja juridike për palët, kontrata nuk është deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 e në vijim në ILDKPKI.

**Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**1.39** Referuar nenit 9, të ligjit nr. 7661, datë 19.1.1993, “Për kontabilitetin”, parashikohet ndër të tjera se çdo dokument kontabël mbështetet në një dokument justifikues (fillestar), si: fatura, fletëhyrja, fletëdalja, mandatarkëtimi etj. Komisioni vlerëson se subjekti nuk arriti të provonte

---

<sup>18</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 5.8.2019.

me dokumentacion ligjor justifikues pagesën e kështit të parë me fondet e tërhequra nga kredia, e cila nuk u provua si nga vetë subjekti, ashtu edhe nga shoqëria ndërtimore “\*\*\*\*” sh.p.k., e cila gjatë hetimit të Komisionit konfirmoi se nuk i disponon këto dokumente. Për pasojë, pretendimet e subjektit se pagesa e kështit të parë është kryer në vitin 2007, me fondet e tërhequra nga kredia mbeten në nivel deklarativ.

**1.40** Gjatë hetimit rezultoi e provuar se apartamenti i porositur te shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në vitin 2007, nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur, z. A.P. në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, e në vijim. Bazuar në germën “dh”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit mbart detyrimin të deklarojë detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë me lidhjen e kësaj kontrate.

**1.41** Bazuar në faktet e analizuara gjatë hetimit administrativ, por edhe referuar shpjegimeve të subjektit pas kalimit të barrës së provës, konstatohet se kontrata e sipërmarrjes (porosisë) nr. \*\*\* prot., datë 27.9.2007, me sipërmarrës shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe porositës personin e lidhur, z. A.P., ka qenë fiktive dhe qëllimi i hartimit të saj ka qenë marrja e kredisë bankare prej 40.000 euro në “Raiffeisen Bank”. Fiktivitetin e kontratës së lartpërmendur e konfirmoi edhe subjekti i rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore. Subjekti, gjithashtu, nuk arriti të provojë revokimin e kësaj kontrate. Vlen të përmendim faktin që kontrata e mëvonshme e lidhur mes shoqërisë ndërtimore “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe shtetas D.D., është zgjidhur me akt revokimi nga shoqëria ndërtimore, ndërkohë që kontrata me personin e lidhur me subjektin e rivlerësimit nuk është kryer me akt revokimi.

**1.42** Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se bazuar në pikën “ç”, të nenit 92, të Kodit Civil, veprimet juridike që bëhen në marrëveshje të palëve pa pasur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluar), janë të pavlefshme dhe nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Si rezultat, lidhja e kontratës, vetëm për t’iu paraqitur bankës në funksion të përfitimit të kredisë dhe jo qëllimit të vetë palëve, përmban elemente të fiktivitetit, pasi marrëveshja e palëve kontraktore nuk ka pasur qëllim që të sjellë pasoja juridike të ligjshme.

**1.43** Në këtë konkluzion arrijmë edhe duke iu referuar jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në vendimin nr. \*\*\*, datë 17.7.2019, sipas të cilit, veprimet e kryera për lidhjen e kontratës së sipërmarrjes, thjesht për të realizuar marrjen e kredisë dhe blerjen më pas të një apartamenti tjetër, duket se janë kryer në mashtrim të ligjit.

**1.44** Për këto arsye, në kushtet kur Komisioni pa marrë rolin e një gjykate civile që konstaton pavlefshmëritë e veprimeve juridike, në kontekst të zgjidhjes së pasojave të palëve, por në analizim të natyrës së ligjshme ose jo të ligjshme të transaksioneve të kryera, çmon se e gjithë veprimtaria për realizimin e këtyre veprimeve juridike ka elemente të paligjshme brenda saj, të cilët prekin legjitimitetin e pasurisë së krijuar në përmbyllje të këtij transaksioni, pavarësisht faktit nëse kjo është një pasuri e shtuar ose jo e subjektit, por që sigurisht është një pasuri në pronësi të saj, për pasojë objekt verifikimi për sa i përket ligjshmërisë në kuptim të pikës 3, nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

**Burimi II – Lidhur me vlerën 61.000 euro, të përfituar nga shitja e apartamentit të mëparshëm**

**1.45** Komisioni, për të konkluduar në lidhje me burimin e ligjshëm të shumës prej 61.000 euro, ka analizuar blerjen dhe shitjen e apartamentit, si më poshtë:

**1.46 Lidhur me blerjen e këtij apartamenti**, bazuar në dokumentacionin e administruar nga ILDKPKI-ja, rezulton se ky apartament është blerë me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 10.12.2002, me palë shitëse familjen K. dhe palë blerëse shtetasin A.P., me objekt shitjen e apartamentit nr. \*\*\*, me sip. ndërtimi 72.5 m<sup>2</sup> dhe sip. respektive trualli 5.8 m<sup>2</sup>, k. \*\*\*, Rr. “\*\*\*\*” (\*\*\*) , Tiranë. Çmimi i blerjes ka vlerën 3.647.384 lekë, likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale, në llogarinë e shitësve në “Tirana Bank”.

**1.47** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, personi i lidhur me subjektin, z. A.P., ka deklaruar se burimi i krijimit të këtij apartamenti janë të ardhurat e krijuara nga ndihmesa e babait dhe vjehrrit të tij, si dhe të ardhurat modeste të kursyera nga moskryerja e ceremonisë martesore.

**1.48** Ndërkohë që në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi se si burim krijimi për blerjen e apartamentit kanë shërbyer të ardhurat nga punësimi i saj dhe i bashkëshortit. Më tej, subjekti deklaroi se të ardhurat nga ndihmesa e prindërve, që janë deklaruar nga bashkëshorti i saj në vitin 2003, nuk kanë shërbyer për blerjen e apartamentit por për mobilimin e tij.

**1.49** Për të provuar deklaratimet lidhur me të ardhurat e prindërve dhe të bashkëshortit, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar dokumentacion justifikues për babanë<sup>19</sup> dhe bashkëshortin<sup>20</sup>, ku nuk specifikohen shumat përkatëse. Komisioni vlerëson se këto dokumente nuk përcaktojnë të ardhurat që ka marrë babai dhe personi i lidhur/bashkëshorti, si dhe nuk vërtetohet nëse për këto të ardhura janë paguar apo jo tatimet përkatëse. Për këtë arsye, dokumentacioni i paraqitur nuk është marrë në konsideratë në analizën financiare, pasi nuk ka pasur vlera të specifikuar.

**1.50** Duke u bazuar në dokumentacionin e administruar nga hetimi, Komisioni vlerëson se nuk do të merren në konsideratë në analizën financiare: (1) të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga bursa në Shkollën e Magjistraturës dhe nga mësimdhënia në Universitetin e Vlorës, për shkak se mungon dokumentacioni ligjor justifikues; (2) të ardhurat e personit të lidhur/bashkëshortit nga Ndërmarrja e Gjellimit Tiranë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë, si dhe të ardhurat nga emigracioni - për shkak se mungon dokumentacioni ligjor justifikues; (3) shpenzimet jetike për shkak të mungesës së një informacioni të plotë mbi të ardhurat.

**1.51** Nga faktet e analizuar më lart, bazuar në nenin 52, të ligjit 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, por duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti kanë pasur mungesë të ardhurash të ligjshme në vlerën 1.821.025 lekë, për blerjen e apartamentit me sip. 72.5 m<sup>2</sup>, pa përlllogaritur fare shpenzime jetike.

**1.52** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, dërgoi shpjegime dhe prova për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, duke deklaruar se:

---

<sup>19</sup> Vërtetim i z. N.Zh., drejtor i Ndërmarrjes Komunale Banesa Përmet; licencë për zbatim punimesh, lëshuar nga Komisioni i Dhënies së Licencave në Ministrinë e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, datë 11.11.1994; vendim nr. \*\*\*, datë 9.12.1994, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, për regjistrimin si person fizik privat të shtetasit Th.Th. P.

<sup>20</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 15.4.2015, i drejtorisë së inspektimit dhe burimeve njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.

(i) Për të provuar të ardhurat nga bursa në Shkollën e Magjistraturës dhe të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur/bashkëshorti, z. A.P., në Ndërmarrjen e Gjelbërimit Tiranë, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë, subjekti dorëzoi vërtetimet<sup>21</sup> nga: (1) Shkolla e Magjistraturës ku specifikohet se për vitet 1997, 1998 dhe 1999, të ardhurat *neto* nga bursa kanë qenë 359.325 lekë; (2) Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ku specifikohet se për vitet 1998, 1999 dhe 2000, të ardhurat *neto* të personit të lidhur kanë qenë 305.672 lekë + 386.915 lekë + 28.812 lekë = 721.399 lekë; (3) Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Bulqizë ku specifikohet se për vitin 2000, të ardhurat *neto* të personit të lidhur kanë qenë 379.712 lekë; (4) Ndërmarrja e Gjelbërimit Tiranë, për të vërtetuar të ardhurat, subjekti ka paraqitur kopje të librezës së punës së personit të lidhur, ku pasqyrohet punësimi si jurist. Për të ardhurat e përfituara nga mësimdhënia në Universitetin e Vlorës, subjekti deklaroi se i paraqet vetëm për efekt të llogaritjes, pasi pagesa është kryer pas vitit 2002, për pasojë nuk ka ndikim tek të ardhurat për blerjen e apartamentit me sip. 72.5 m<sup>2</sup>. Subjekti, më tej, deklaroi se nuk është shprehur asnjëherë se të ardhurat nga emigracioni të personit të lidhur, z. A.P., kanë shërbyer si burim të ardhurash për blerjen e apartamentit me sip. 72.5 m<sup>2</sup>. Lidhur me të ardhurat për periudhën tetor 2000 – prill 2001, nuk ka të ardhura të pasqyruara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Në evidencat e mbajtura nuk del e pasqyruar pagesa për kohën e paaftësisë në punë për këtë periudhë. Si rrjedhojë, ka mbetur e papërfshirë në të ardhurat e subjektit për shkaqe të pavarura nga vullneti i saj.

ii) Subjekti rishpjegoi dhe risaktësoi deklaratimet e saj, lidhur me të ardhurat në vlerën 600.000 lekë, dhuratë *cash* nga prindërit e subjektit dhe prindërit e personit të lidhur, secili në vlerën 300.000 lekë për lidhje martesë. Këto të ardhura nuk kanë qenë përcaktuese për blerjen e apartamentit me sip. 72.5 m<sup>2</sup>, por kanë shërbyer për të plotësuar fondin me të cilin është blerë. Fondi i blerjes është krijuar nga të ardhurat e pagave të punësimit të subjektit dhe të bashkëshortit, kurse pjesa tjetër (më së shumti) ka shkuar për mobilim të brendshëm.

iii) Për sa i përket shpenzimeve jetike, në vitet e punësimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, subjekti deklaroi se së bashku me bashkëshortin kanë jetuar në shtëpinë e lindjes së saj në Vlorë dhe nuk kanë pasur shpenzime jetese. Bashkëshorti i subjektit, gjatë kohës së punësimit në Bulqizë dhe Kurbin, ka përdorur makinën dhe karburantin e institucioneve përkatëse ku ka qenë i punësuar.

Duke marrë në konsideratë sa më sipër, subjekti kërkoi rishikimin e tabelës së analizës financiare.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**1.53** Duke qenë se subjekti dorëzoi dokumentacion ligjor justifikues për të ardhurat e pagave për periudhën në të cilën mungonte ky dokumentacion, Komisioni kreu analizën financiare për

---

<sup>21</sup> Kopje e librezës së punës nga Ndërmarrja e Gjelbërimit Tiranë; vërtetim nga Shkolla e Magjistraturës nr. \*\*\* prot., datë 23.12.2019; vërtetim nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, nr. \*\*\* prot., datë 24.12.2019; vërtetim page nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Bulqizë; certifikatë martesë datë 27.12.2019, nr. serial \*\*\*, lëshuar nga zyra e gjendjes civile (arkiva), Bashkia Tiranë; përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2019, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 27.12.2019, e Institutit të Sigurimeve Shoqërore Vlorë; përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 30.12.2019, e Këshillit të Lartë Gjyqësor.



periudhën 1998 – 2002, duke përfshirë të ardhurat, si dhe shpenzimet jetike për dy persona (subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti).

**1.54** Komisioni vlerëson se për efekt të analizës financiare janë marrë në konsideratë: (1) të ardhurat nga bursa e subjektit në shumën 327.537 lekë<sup>22</sup>; (2) vërtetimi i Institutit të Sigurimeve Shoqërore Vlorë, për bazën e vlerësuar, periudha nëntor 2000 – prill 2001, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, të ardhura nga paga e subjektit në shumën 43.831 lekë (llogaritur paga neto sipas legjislacionit që ka qenë në fuqi). Në lidhje me të ardhurat për periudhën dhjetor 2000 – mars 2001, të cilat mungojnë në këtë vërtetim, subjekti ka deklaruar se ka qenë me raport paaftësie dhe se këto raporte janë dorëzuar në zyrën e financës së gjykatës. Referuar pikës 1, të nenit 22, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ardhurat për sëmundje janë 70 % të mesatares ditore të bazës së vlerësueshme të vitit të fundit kalendarik, kur i siguruari ka deri në 10 vjet sigurim. Meqenëse subjekti ka pasur vetëm një muaj punësim, pikërisht, kjo mund të ketë qenë arsyeja se përse subjekti nuk ka përfituar të ardhura për këtë periudhë; (3) të ardhurat nga paga e bashkëshortit të subjektit, në shumën 721.399 lekë<sup>23</sup>; (4) të ardhurat nga paga e bashkëshortit të subjektit në shumën prej 379.712 lekësh, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibrë.

**1.55** Në lidhje me disa nga të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, nuk janë konsideruar, konkretisht: (1) të ardhurat nga paga në Prokurorinë e Rrethit Kurbin, në vlerën 74.315 lekë. Sipas përshkrimit në vërtetim kjo shumë ka natyrën e dietës. Duke qenë se dietat janë vlera monetare të destinuara për të mbuluar shpenzimet e kryera gjatë një veprimtarie të caktuar, kjo shumë nuk është përfshirë në analizën financiare<sup>24</sup>; (2) të ardhurat nga prindërit përkatës të subjektit dhe të personit të lidhur, në shumën totale 600.000 lekë, për shkak të mosorganizimit të ceremonisë martesore. Ky deklaram është bërë nga subjekti i rivlerësimit, vetëm pas kalimit të barrës së provës për justifikimin e burimit të blerjes së apartamentit me sip. 72.5 m<sup>2</sup>; (3) pretendimet e subjektit se së bashku me bashkëshortin nuk kanë pasur asnjë kosto jetese gjatë kohës që kanë jetuar te prindërit e saj, pasi shpenzimet e përllogaritura janë në nivele minimale dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar dokumentacion justifikues për të ardhurat e prindërve. Për këtë arsye u përllogaritën dhe u përfshinë në analizën financiare shpenzimet jetike në shumën 859.728 lekë<sup>25</sup>.

**1.56** Komisioni arrin në përfundimin se pas rishikimit të analizës financiare, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti, rezulton **me mungesë të ardhurash të ligjshme** në vlerën 1.208.274 lekë, për blerjen e apartamentit me sip. 72.5 m<sup>2</sup>, që më vonë është shitur dhe këto të ardhura kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit *duplex*.

**1.57 Lidhur me shitjen e këtij apartamenti**, subjekti, në deklaratën “Vetting” ka deklaruar se si burim për blerjen e këtij apartamenti kanë shërbyer të ardhurat në vlerën 61.000 euro, nga shitja e një pasurie të paluajtshme me kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 26.9.2012, me palë shitëse subjektin Marsela Balili dhe personin e lidhur, z. A.P., dhe palë blerëse shtetasen N.P.

<sup>22</sup> Vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 23.12.2019, i Shkollës së Magjistraturës (vlera 327.537 lekë i përket periudhës 1998 – 1999).

<sup>23</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 24.12.2019, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

<sup>24</sup> Vendimi nr. \*\*\* (JR), datë 5.4.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

<sup>25</sup> Në mungesë të të dhënave zyrtare statistikore, për vitet 1998 – 1999 u konsiderua një shpenzim prej 5.000 lekësh/muaj për person.

**1.58** Sipas dokumentacionit të administruar nga “Union Bank”<sup>26</sup> (bankë e cila ka përthithur Bankën Ndërkombëtare Tregtare) dhe Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave<sup>27</sup>, personi i lidhur, z. A.P., ka kryer derdhje në shumën prej 70.000 euro në llogarinë e shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., të detajuara, si më poshtë:

- Në datën 13.2.2012, shumën 10.000,00 euro, me përshkrim “depozitë në llogari për këtë apartamentesh A.P.” (transaksion i pacituar në shkresën e DPPP-së).
- Në datën 20.6.2012, shumën 10.000,00 euro, me përshkrim “këst apartamenti” (sipas raportimit në DPPP, derdhje nga z. A.P., kurse në lëvizjet e llogarisë bankare nuk figuron emër).
- Në datën 13.7.2012, shumën 10.000,00 euro, me përshkrim “derdhje në llogari për pagesë këst apartamenti” (sipas raportimit në DPPP-së derdhje nga z. A.P., kurse në lëvizjet e llogarisë bankare nuk figuron emër).
- Në datën 19.7.2012, shumën 10.000,00 euro, me përshkrim “depozitë në llogari për pagesë këst apartamenti z. A.P.”.
- Në datën 6.8.2012, shumën 20.000,00 euro, me përshkrim “derdhje për këst apartamenti z. A.P.”.
- Në datën 7.8.2012, shumën 10.000,00 euro, me përshkrim “derdhja e fundit e kështit të apartamentit, z. A.P.”.

**Pra, sipas dokumentacionit të administruar, likuidimi i apartamentit *duplex* nga personi i lidhur, z. A.P., është realizuar në periudhën shkurt 2012 – gusht 2012.**

**1.59** Nga hetim i Komisionit dhe më konkretisht, dokumentacioni i administruar nga “Tirana Bank”, u provua se blerësi, shtetasja N.P., ka kryer likuidimin e vlerës së apartamentit në rrugë bankare në një shumë totale prej 59.940,82 euro, si më poshtë:

- Në datën 27.9.2012, shuma e transferuar 27.447,00 euro.
- Në datën 28.9.2012, shuma e transferuar 12.629,00 euro.
- Në datën 1.10.2012, shuma e transferuar 7.750,00 euro.
- Në datën 1.10.2012, shuma e transferuar 12.114,82 euro.

**1.60** Më tej, personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka kryer tërheqje në shumën totale 59.800,00 euro, të detajuara, si më poshtë:

- Në datën 2.10.2012, shuma e tërhequr 20.000,00 euro
- Në datën 15.10.2012, shuma e tërhequr 10.000,00 euro
- Në datën 2.11.2012, shuma e tërhequr 10.000,00 euro
- Në datën 12.11.2012, shuma e tërhequr 500,00 euro
- Në datën 5.12.2012, shuma e tërhequr 300,00 euro
- Në datën 13.12.2012, shuma e tërhequr 19.000,00 euro

**Pra, rezultoi e provuar se personi i lidhur, z. A.P., e ka tërhequr shumën e përfituar nga shitja e apartamentit në periudhën tetor 2012 – dhjetor 2012.**

**1.61** Nisur nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit

<sup>26</sup> Shkresë nr. \*\*\*, datë 15.11.2019.

<sup>27</sup> Shkresë nr. \*\*\*, datë 10.5.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, për sa më poshtë vijon:

- i. Duket se ka mungesë të të ardhurave të ligjshme në shumën prej 61.000 euro, si burim për blerjen e apartamentit *duplex* në Tiranë, për shkak se shuma prej 61.000 euro e deklaruar si e ardhur e përfituar nga shitja e apartamentit me sip. 72.5 m<sup>2</sup>, në Rr. “\*\*\*”, është tërhequr nga llogaria bankare përkatëse në periudhën 2.10.2012 – 13.12.2012, ndërkohë që pagesa e apartamentit *duplex* është kryer gjatë periudhës 13.2.2012 – 7.8.2012.

**1.62** Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, dërgoi shpjegime dhe prova për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, si më poshtë vijon:

- i. Në llogarinë bankare të personit të lidhur, z. A.P., në “Tirana Bank”, është derdhur shuma prej 84.000 euro, pagesë që i përkiste marrëdhënies juridike të lindur midis shtetasve P.K. dhe E.Ll. Në këtë marrëdhënie personi i lidhur, z. A.P., ka vepruar në cilësinë e përfaqësuesit të znj. E.Ll. me prokurën e posaçme nr. \*\*\*, datë 1.4.2010.
- ii. Prej shumës 84.000 euro, duke marrë leje për këtë veprim nga titullarja znj. E.Ll., janë derdhur këste në llogari të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., sipas bisedimeve të kryera në vitin 2012 dhe është rënë dakord që nëse do të fillonte shlyerja e kësteve të apartamentit *duplex*, marrëdhënia e nisur me aktmarrëveshjen datë 12.12.2007, do të finalizohet me kontratë shitjeje. Subjekti, me lidhjen e kontratës së shitjes, vendosi kolateral apartamentin *duplex*, duke liruar nga kolaterali apartamentin me sip. 72.5 m<sup>2</sup> për ta shitur, të ardhurat e të cilit shkuan për blerjen e apartamentit *duplex*, në kuptimin që shërbyen për të zëvendësuar shumën e përdorur përkohësisht nga shuma 84.000 euro, që i përkiste titullares znj. E.Ll.
- iii. Subjekti deklaroi se përveç shumës që u përdor përkohësisht nga vlera 84.000 euro, në këtë kohë, zotëronin edhe vlerën prej 40.000 euro, të marrë hua nga shtetasi M.M., në korrik të vitit 2011 (siç edhe kishte deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit përkatës).

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

Komisioni vlerëson se kësti në vlerën 61.000 euro, rezulton i paprovuar nga burime të ligjshme, për arsye se:

**1.63** Subjekti nuk ka deklaruar në ILDKPKI për vitin 2011 gjendjen e fondeve të përdorura në pronësi të shtetasës E.Ll., pretendime të cilat subjekti i paraqiti vetëm pasi u njoh me rezultatet e hetimit.

Për të provuar këto të ardhura, referuar germave “d” dhe “dh”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjekti duhet të kishte deklaruar:

- **vlerën e likuiditeteve, gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, llogari rrjedhëse, depozitë, bono thesari, huadhënie;**
- **detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë;**

▪ **shlyerjen e detyrimeve.**

Në seksionin “detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” (f. 5), në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, subjekti duhet të kishte deklaruar shlyerjen e shumës prej 70.000 euro ndaj shtetases E.Ll., si dhe shlyerjen po në këtë vit të vlerës totale të detyrimit.

**1.64** Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, si burim krijimi përdorimin e këtyre të ardhurave në vitin 2012, duke përcaktuar qartë se një nga burimet në momentin e kryerjes së pagesës së kësteve të apartamentit, ishte shuma e përdorur nga gjendja e fondeve në pronësi të shtetases E.Ll.

**1.65** Komisioni çmon se referuar jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, vendimit nr. \*\*\*, datë 18.4.2019 dhe udhëzimit nr. \*\*\*, të inspektorit të përgjithshëm të ILDKPKI-së, pika 7, për çdo pasuri në pronësi të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, *duhet të deklarojë burimin, në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre. Më tej, në formularin e deklarimit të pasurisë për procesin e rivlerësimit, në rubrikën “deklarimi i pasurive”, përcaktohet qartësisht se objekt i deklarimit janë: [...] të gjitha pasuritë e akumuluar ndë vite, deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, sipas pikës 11, nenit 3, ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në zotërim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të subjektit.*

**1.66** Më tej, subjekti nuk arriti të provojë me dokument ligjor justifikues të drejtën e përdorimit të shumës prej 84.000 euro nga personi i lidhur, z. A.P., për pasojë shpjegimet e subjektit mbeten në nivel deklarativ.

**1.67** Në konkluzion, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura nga burime të ligjshme për pagimin e këstit në vlerën 61.000 euro, në periudhën shkurt – gusht të vitit 2012, referuar dokumentacionit të administruar nga “Union Bank”<sup>28</sup>.

**Burimi i III – Lidhur me shumën 14.000 euro, marrë hua në vitin 2011, nga shtetasi M.M.**

**1.68** Në seksionin “të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar: *“Shuma 40.000 euro marrë hua pa interes nga shtetasi M.M., në vitin 2011, pa dokument, me qëllim hapjen e një aktiviteti fitimprurës nga bashkëshorti në kushtet e penalizimit të të dyve, por që u përdor për banesën në vitin 2012. 14.000 euro shkuan për blerje banese, 4.000 euro për makinën tip “Ford Fiesta”, dhe 22.000 euro u përdorën për rregullimin dhe mobilimin e banesës”.*

**1.69** Nuk është e qartë lidhja e subjektit me shtetasin huadhënës, z. M.M., dhe as kushtet e kësaj huaje.

**1.70** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, të dërguar nga subjekti (por jo nga ILDKPKI-ja) dhe në vazhdim, si dhe në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar se shuma e marrë hua shtetasit M.M., ka mbetur e pashlyer.

---

<sup>28</sup> Shkresë nr. \*\*\*, datë 15.11.2019.

**1.71** Në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion për mjaftueshmërinë dhe ligjshmërinë e krijimit të shumës 40.000 euro, nga shtetasi M.M.

**1.72** Në pyetësoin standard të Komisionit, subjekti ka bashkëlidhur ekstraktin e shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., me administrator z. M.M., dhe lëvizjet e llogarive bankare në emër të shoqërisë, përkatësisht nga “Banka Kombëtare Tregtare” për periudhën 1.1.2011 – 31.12.2012 dhe nga “Credins Bank” për periudhën 22.2.2007 – 31.12.2013. Në këto *statemente* pasqyrohen transfertat (kreditime) nga klientët e shoqërisë dhe tërheqje nga llogaria të shumave të ndryshme nga shtetasi M.M..

**1.73** Referuar tërheqjeve të mësipërme, të kryera nga shtetasi M.M. në llogaritë bankare të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., Komisioni konstaton se në asnjërën prej këtyre tërheqjeve nuk specifikohet destinacioni i shumave të tërhequra.

**1.74** Gjithashtu, rezulton se: (i) shtetasi M.M. është administrator i shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., dhe ortak me 50 % të kuotave; dhe (ii) Drejtoria Rajonale e Tatimeve<sup>29</sup> konfirmon se kjo shoqëri nuk ka shpërndarë dividend.

**1.75** Nisur nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52, të ligjit 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, si më poshtë vijon:

- i. ka mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor për marrjen e huas në shumën 40.000 euro, nga shtetasi M.M. në vitin 2011;
- ii. ka mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor lidhur me të ardhurat e shtetasit M.M., për të dhënë hua shumën 40.000 euro.

**1.76** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, dërgoi shpjegime dhe prova<sup>30</sup> për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, si më poshtë vijon:

- i. Bashkëshorti i subjektit ka marrë hua pa interes në vlerën 40.000 euro, pa dokument nga shtetasi M.M. Për të provuar gjendjen financiare të shtetasit M.M., subjekti ka paraqitur ekstraktin e shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., me administrator z. M.M., dhe lëvizjet e llogarive bankare të shoqërisë, ku edhe pse në asnjërën prej tyre nuk specifikohet destinacioni i shumave të tërhequra për dhënie huaje, i ka paraqitur dokumentet në funksion të provueshmërisë së gjendjes financiare. Në vitet 2006 – 2015, shtetasi M.M., ka qenë ortak i vetëm i shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k, duke zotëruar gjithë aktivitetin e shoqërisë si pronar dhe administrator i saj.
- ii. Lidhur me faktin se kjo shoqëri nuk ka shpërndarë dividend, subjekti deklaroi se kjo situatë nuk ndikon negativisht gjendjen financiare të shtetasit M.M. sepse: së pari, shuma që huadhënësi jep hua, nuk mund të jetë vetëm fitimi i realizuar në fund të vitit financiar korrespondent me vitin që jepet huaja, sepse gjendja e mjeteve monetare në një datë të caktuar për një subjekt tregtar nuk është e lidhur domosdoshmërisht me fitimin e subjektit në fund të vitit financiar. Nga *statementet* bankare provohen flukset

<sup>29</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.11.2019.

<sup>30</sup> Subjekti dorëzoi deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 6.1.2020, lëshuar nga shtetasi M.M.

hyrëse të parave nga klientët e biznesit të shoqërisë, të cilat janë në vlera të larta; së dyti, fakti se nuk është deklaruar dividendi nga huadhënësi në kuadrin e aktivitetit të tij tregtar, nuk mund të rëndojë mbi huamarrësin duke e konsideruar huan të prejardhur nga burime të paligjshme. Huamarrësi është në mirëbesim se aktiviteti tregtar ushtrohet rregullisht dhe se huaja e marrë rezulton pa “të meta”.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**1.77** Duke qenë se subjekti deklaroi se në vitet 2006 – 2015, shtetasi M.M., ka qenë ortak i vetëm i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., duke zotëruar gjithë aktivitetin e shoqërisë si pronar dhe administrator i saj, Komisioni mori në analizë pasqyrat financiare të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për periudhën 2006 – 2010, për të konstatuar nëse kjo hua është pasqyruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.

- i. Referuar Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 2 (SKK 02) - *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*, kjo hua duhet të ishte pasqyruar në zërin e të drejtave të shoqërisë ndaj palëve të treta apo ndaj vetë ortakut, shtetasit M.M.
- ii. Bazuar në bilancet e shoqërisë për periudhën 2006 – 2010, të përcjella nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, vihet re se në seksionin e aktiveve financiare afatshkurtra dhe afatgjata, nuk pasqyrohet një detyrim i tillë.
- iii. Përkundrazi, në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të vitit 2008, përpiluesit e këtyre pasqyrave, nënshkruar edhe nga shtetasi M.M., në cilësinë e administratorit, shpjegojnë se në zërin “hua të tjera”, të paraqitura në seksionin e detyrimeve të shoqërisë, shuma prej 3.345.587 lekësh, përfaqëson hua të marrë nga persona fizikë për mungesë likuiditeti. Në vitin 2009 dhe 2010, ky zë është rritur më tej me vlerën 2.271.566 lekë duke shkuar në shumën 5.617.153 lekë.
- iv. Për vitin 2011, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., nuk ka dorëzuar pasqyra financiare, ndërkohë që Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në shkresën e saj citon se për vitin 2011 qarkullimi dhe fitimi/humbja janë zero.
- v. Në kushtet e mungesës së pasqyrave financiare për vitin 2011, Komisioni analizoi tërheqjet e kryera nga shtetasi M.M. në llogaritë bankare të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., të dorëzuara nga vetë subjekti i rivlerësimit.
- vi. Komisioni konstatoi se në llogarinë bankare të “Intesa Sanpaolo Bank”, tërheqjet fillojnë në datën 13.10.2011, pra, pas kohës së dhënies së huas. Ndërsa, në lëvizjet e llogarive në bankën “Credins” në vitin 2011 nuk është kryer asnjë tërheqje.
- vii. Gjithashtu, nga dokumentacioni i ndodhur në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit rezulton se ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në datën 11.3.2011 është vendosur një urdhër sekuestroje nga përmbaruesi gjyqësor, shërbimi përmbarimor “\*\*\*\*” sh.p.k., për zbatimin e urdhrit të ekzekutimit për pjesën e pashlyer të një kontrate huaje afatgjatë, ku kreditor rezulton të jetë “Societe Generale Albania”, si debitor shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe dorëzanës z. M.M. Kjo sekuestro është hequr në datën 22.11.2012.

**1.78** Për sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se shtetasi M.M., nuk ka pasur mundësi në vitin 2011 të japë hua shumën 40.000 euro, as si individ dhe as si ortak i shoqërisë “\*\*\*\*”

sh.p.k., për shkak se: (i) si individ, subjekti nuk solli asnjë provë shkresore që të vërtetonte se shtetasi M.M. kishte të ardhura të ligjshme; (ii) si ortak i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor justifikues që ky detyrim ekziston, sipas konstatimeve në pikën 1.77 më lart.

**Burimi IV - Lidhur me shumën 10.000 euro, mbetur pa shlyer sipas kontratës së huas nr. \*\*\*, datë 25.6.2012**

**1.79** Subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” ka paraqitur kontratën e huas nr. \*\*\*, datë 25.6.2012, lidhur ndërmjet shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe personit tjetër të lidhur, z. A.P., për vlerën 10.000 euro. Referuar kontratës, citohet se shitja e apartamentit është bërë në mirëbesim nga shoqëria, pasi blerësi i detyrohet ende 10.000 euro. Ky detyrim lindi si pasojë e zgjerimit në sipërfaqe të apartamentit të porositur nga klienti. Blerësit deklarojnë me vullnet të lirë se këtë detyrim do ta shlyejnë jo më vonë se data 31.1.2013.

**1.80** Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.,<sup>31</sup> i bën me dije Komisionit se pagesat për likuidimin e këtij apartamenti janë bërë nga viti 2007 e në vazhdim, duke i ngelur një diferencë prej 10.000 euro, e shlyer në rrugë bankare. Duke qenë se shoqëria prej kohësh nuk ka aktivitet në fushën e ndërtimit, nuk i disponojnë fizikisht mandatpagesat.

**1.81** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2017, në seksionin detyrime, subjekti deklaroi se detyrimi prej 10.000 euro është shlyer gjatë vitit 2018, dhe do të pasqyrohet në deklarinimin e vitit 2018.

**1.82** Referuar kontratave të shitjes së apartamenti *duplex*, citohet shlyerja e plotë e vlerës së blerjes, në total 125.000 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

**1.83** Sipas dokumentacionit nga “Union Bank” dhe nga DPPPP-ja, rezultoi kryerja e pagesës prej 70.000 euro për apartamentin *duplex*, ndërkohë që subjekti deklaroi se në vitin 2012 ka shlyer 61.000 euro.

**1.84** Nisur nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52, të ligjit 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me ekzistencën e këtij detyrimi, si më poshtë vijon:

- i. ka mospërputhje midis kontratave të shitjes së apartamentit *duplex*, në të cilat citohet shlyerja e plotë e vlerës së blerjes së apartamenteve (me sip. 101.5 m<sup>2</sup> dhe sip. 95 m<sup>2</sup>), në shumën 125.000 euro, shumë kjo e likuiduar jashtë zyrës noteriale dhe kontratës së huas, e cila citon se subjekti ka mbetur 10.000 euro detyrim;
- ii. sipas “Union Bank” dhe DPPPP-së rezultoi se: (1) kryerja e pagesave të kësteve për blerje apartamenti është kryer edhe pas datës së kontratës së shitjes; dhe (2) janë kryer pagesa në shumën totale prej 70.000 euro për apartamentin *duplex*, ndërkohë që subjekti deklaroi që në vitin 2012 ka shlyer 61.000 euro.

**1.85** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, dërgoi shpjegime dhe prova<sup>32</sup> për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, si më poshtë vijon:

<sup>31</sup> Shkresë nr. \*\*\*, datë 23.10.2019.

<sup>32</sup> *Statement* nga “Intesa Sanpaolo Bank” për tërheqje të shumës 1.000.000 lekë, datë 4.1.2018 dhe 500.000 lekë në dhjetor të vitit 2017, që pas konvertimit në euro janë derdhur në llogarinë bankare të shoqërisë 10.000 euro; kopje e mandatarkëtimit

- i. është e vërtetë se në kontratat e shitjes së apartamentit *duplex* citohet shlyerja e plotë e vlerës së blerjes së këtij apartamenti, por nënshkrimi i kontratës së huas e rrëzon vetvetiu shënimin noterial mbi shlyerjen e plotë të vlerës prej 125.000 euro, duke konfirmuar mbetjen e shumës 10.000 euro pa paguar, që u konvertua në një kontratë huaje. Kontratat e shitjes dhe kontrata e huas janë lidhur përpara të njëjtës zyrë noteriale, në të njëjtën datë dhe numrat e kontratave janë të njëpasnjëshëm. Shuma 10.000 euro është likuiduar gjatë vitit 2018, nga fondi i përfituar nga buxheti i shtetit në vitin 2017, pas rikthimit në detyrë të subjektit deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2018.
- ii. është e vërtetë se janë kryer pagesa në vlerën 70.000 euro (të kryera para dhe pas datës së kontratave të shitjes 25.6.2012), duke i derdhur në llogarinë bankare të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., dhe duke i cilësuar si këste për blerje apartamenti. Vlera 70.000 euro e përdorur përkohësisht nga vlera 84.000 euro, që i përkiste titullares znj. E.Ll., u zëvendësua me vlerën e përfituar nga shitja e apartamentit me sip. 72.5 m<sup>2</sup>, në shumën 61.000 euro. Për ta plotësuar këtë shumë janë përdorur edhe 14.000 euro të tjera, nga shuma totale prej 40.000 euro, marrë hua nga shtetasi M.M., prej të cilave 9.000 euro shërbyen për të plotësuar shumën 70.000 euro (61.000 + 9.000 = 70.000) dhe 5.000 euro iu paguan shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., për të çuar në vlerën 115.000 euro, shumën e shlyer deri në fund të vitit 2012.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**1.86** Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm faktin se përse ka noterizuar dhe nënshkruar brenda të njëjtës ditë dy kontrata lidhur me blerjen e apartamentit *duplex*, të cilat në përmbajtje kundërshtojnë njëra-tjetrën lidhur me të njëjtin fakt.

**1.87** Subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion provues që i ka paguar *cash* shumën prej 5.000 euro, shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. Në këto kushte, subjekti ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën “Vetting” dhe atë të vitit 2012.

### **Konkluzion lidhur me pasurinë apartament *duplex*, me sip. 196.5 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. “\*\*\*”, Tiranë**

**1.88** Në përfundim të rezultateve të hetimit kryesisht, duke marrë në konsideratë konkluzionet e dala për secilin burim nga analiza financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e apartamentit *duplex* në shumën 124.000 euro.

**1.89** Bazuar në nenin 52, të ligjit 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

**1.90** Subjekti i rivlerësimit, pas shpjegimeve të dhëna më sipër, kërkoi nga Komisioni rishikimin e analizës financiare duke pasqyruar drejt të gjitha rrethanat që lidhen me to.

**1.91** Komisioni, pas rishikimit të provave dhe shpjegimeve të subjektit, bazuar në konstatimet e përmendura më sipër, pas analizimit të secilit burim lidhur me mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur/bashkëshortit arriti në përfundimin se **nuk kanë**

---

datë 16.3.2018, të “Intesa Sanpaolo Bank” për depozitimin e shumës 10.000 euro në nr. e llogarisë \*\*\*, të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.; vërtetim datë 20.3.2018, me të cilin vërtetohet se personi i lidhur z. A.P. e ka shlyer shumën 10.000 euro, mbetur borxh shoqërisë nga blerja e apartamentit *duplex*.



**pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e apartamentit *duplex*, të ndodhur në Rr. “\*\*\*”, Tiranë.**

## **2. Automjeti tip “Ford Fiesta”, viti i prodhimit 2005, me targa \*\*\***

**2.1** Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron një automjet tip “Ford Fiesta”, blerë sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 3.10.2012, në vlerën 4.000 euro. Pjesa takuese: 50 %. Si burim krijimi subjekti deklaron: nga shuma prej 40.000 euro marrë hua shtetasit M.M. në vitin 2011. Subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues për pronësinë e automjetit<sup>33</sup>, lidhur me vërtetimin e deklarimeve të saj, por jo për burimin e krijimit.

**2.2** Në lidhje me përputhshmërinë e deklaramit, nisur nga dokumentacioni i administruar nga DRSHTRr-ja<sup>34</sup>, nuk ka të dhëna për këtë mjet, pra, nuk rezulton të ketë qenë i regjistruar në emër të personit të lidhur, z. A.P. Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar nga ILDKPKI-ja, rezulton se DRSHTRr-ja Tiranë, në përgjigjen elektronike, datë 18.5.2018, sqaron se automjeti me targa \*\*\*, nuk figuron i regjistruar në emër të shtetasit A.P. Rezulton se ky automjet është ende në pronësi të shtetasit N.M.R.<sup>35</sup>, pra, deklarimi i subjektit të rivlerësimit nuk përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit.

**2.3** Në lidhje me burimin e krijimit, nga hetimi i Komisionit konstatoi se: në seksionin “të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar shumën 40.000 euro, të marrë hua pa interes nga shtetasi M.M., në vitin 2011 pa dokument, me qëllim hapjen e një aktiviteti fitimprurës nga bashkëshorti në kushtet e penalizimit të të dyve, por që u përdor për banesën në vitin 2012. Nga kjo shumë (40.000 euro) 14.000 euro shkuan për blerje banese, 4.000 euro për automjetin tip “Ford Fiesta” dhe 22.000 euro u përdorën për rregullimin dhe mobilimin e banesës.

**2.4** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit “Ford Fiesta”, në vlerën 4.000 euro si burim krijimi nga shuma e marrë hua shtetasit M.M.

**2.5** Referuar kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 3.10.2012, automjeti është shitur nga shtetasi N.R. dhe është blerë nga personi i lidhur, z. A.P., në vlerën 4.000 euro, shumë e cila është likuiduar përpara nënshkrimit të kësaj kontrate.

**2.6** Në pyetësorin nr. 2, subjekti deklaroi se automjetin tip “Ford Fiesta” e ka shitur dhe në maj të vitit 2018 është pajisur me automjetin tip “Chevrolet Captiva”.

**2.7** Nga kontrolli i sistemit të AMF-së rezultoi se: për periudhën 3.10.2012 – 2.10.2013, polica e sigurimit të mjetit rezulton në emër të personit të lidhur, z. A.P. (pronar) dhe subjektit të rivlerësimit (përdoruese); për periudhën 30.8.2016 – 29.8.2017 dhe 6.9.2017 – 5.9.2018, polica e sigurimit të mjetit rezulton në emër të z. N.R. (pronar) dhe personit të lidhur, z. A.P. (përdorues); për periudhën 14.1.2019 – 13.10.2020, polica e sigurimit të mjetit rezulton në emër të z. N.R. (pronar).

---

<sup>33</sup> Kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 3.10.2012, me palë shitëse shtetasin N.R., dhe palë blerëse shtetasin A.P., për blerje e automjetit tip “Ford Fiesta”, në shumën 4.000 euro, viti i prodhimit 2005, me targa \*\*\*. Bashkëlidhur kopja nga regjistri i barrëve sigurorese.

<sup>34</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.8.2019.

<sup>35</sup> Bashkëngjitur dokumentacionit të DRSHTRr-së, gjendet kopje e printimit nga sistemi, të lejes së qarkullimit nr. \*\*\*, lidhur me gjendjen aktuale të automjetit me targa \*\*\*.

**2.8** Në lidhje me mjaftueshmërinë dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit, është trajtuar gjatë analizimit të huas së dhënë nga personi i lidhur, z. M.M.

**2.9** Nga faktet e analizuara, bazuar në nenin 52, të ligjit 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, si më poshtë vijon:

- i. deklarimi i subjektit të rivlerësimit nuk përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit;
- ii. ka mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor për të ardhurat e shtetasit M.M., për të dhënë hua shumën 40.000 euro.

**2.10** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, dërgoi shpjegime dhe prova për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, si më poshtë vijon:

- i. Për shkak se ishte kryer ç’regjistrimi i automjetit, leja e qarkullimit ka figuruar në emër të shtetasit N.R. Në vitin 2019, kur doli nevoja e shitjes së automjetit, u mbajt deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 9.1.2019, sipas së cilës palët A.P. dhe N.R. deklarojnë se revokojnë kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 3.10.2012, me palë shitëse shtetasin N.R. dhe palë blerëse z. A.P., pa pasur detyrime financiare ndaj njëri-tjetrit dhe më pas është lidhur kontrata e shitblerjes së automjetit nr. \*\*\*, datë 10.1.2019, me shitës shtetasin N.R. dhe blerësin e ri, pasi vetëm kështu mund të kalonte pronësia tek blerësi i radhës. Subjekti, gjithashtu, deklaroi se kishte edhe një mënyrë tjetër ligjore për të bërë ndryshimin e emrit në lejen e qarkullimit, por koha e gjatë që kishte kaluar pasohej me pagesë gjobe administrative, kështu që zgjodhi rrugën tjetër, duke ftuar shtetasin N.R. të revokonte kontratën me z. A.P. dhe më pas të bëhej shitja.<sup>36</sup>
- ii. Më tej, subjekti deklaroi se burimi i krijimit të shumës 4.000 euro që ka shërbyer për të blerë automjetin tip “Ford Fiesta”, është i ligjshëm. Mungesa e dividendit të huadhënësit z. M.M. për kohën e huamarrjes nuk mund ta ngarkojë me përgjegjësi për paligjshmëri të të ardhurave si huamarrës në mirëbesim.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**2.11** Referuar nenit 93, të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, regjistrimi i automjeteve bëhet brenda 10 ditëve në rast ndryshimi të pronësisë së automjeteve.

**2.12** Më tej, sikundër është trajtuar edhe më lart, Komisioni arriti në përfundimin se shtetasi M.M. nuk ka pasur mundësi të japë hua shumën 40.000 euro, në vitin 2011, as si individ, as si ortak i shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. Si rezultat, subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë të ardhurash të ligjshme për blerjen e automjetit tip “Ford Fiesta” në vlerën 4.000 euro, në vitin 2012.

## **3. Llogari “\*\*\* – Intesa Sanpaolo Bank”**

### **Faktet nga hetimi administrativ kryesisht**

**3.1** Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se disponon llogari “\*\*\* - Intesa Sanpaolo Bank” për fëmijë të mitur, me gjendje deri në datën 20.1.2017:

<sup>36</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 9.1.2019, kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 10.1.2019, e automjetit.

për fëmijën e parë 1.243.760,82 lekë, për fëmijën e dytë 681.933,82 lekë. Pjesa takuese: 50 %. Si burim krijimi subjekti deklaron: “Llogari të hapura që në kohën e lindjes së secilit fëmijë, duke derdhur vitin e parë shumat e mbledhura nga burimet e familjarëve dhe të afërmeve dhe në vijim, shuma simbolike çdo vit duke u shtuar edhe prej interesave bankare” Subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues<sup>37</sup> për vërtetimin e deklarimeve.

**3.2** Në lidhje me përputhshmërinë e deklaramit, nga dokumentacioni i administruar nga banka<sup>38</sup>, konfirmohet se subjekti i rivlerësimit në datën 20.1.2017, disponon llogari “\*\*\*\*” me nr. \*\*\*, në vlerën 1.243.760,82 lekë dhe me nr. \*\*\*, në vlerën 681.933,82 lekë.

i) Në lidhje me llogarinë nr. \*\*\*, Komisioni konstaton se është çelur në datën 16.4.2003, me një depozitim fillestar në shumën 80.000 lekë dhe gjatë viteve janë kryer depozitime të vazhdueshme, si dhe janë gjeneruar interesa. Nga kjo llogari nuk është kryer asnjë tërheqje.

ii) Në lidhje me llogarinë nr. \*\*\*, Komisioni konstaton se është çelur në datën 22.7.2005, me një depozitim fillestar në shumën 20.000 lekë dhe gjatë viteve janë kryer depozitime të vazhdueshme, si dhe janë gjeneruar interesa. Nga kjo llogari nuk është kryer asnjë tërheqje.

**3.3** Komisioni, pas analizimit të mundësive financiare të subjektit të rivlerësimit për krijimin e këtyre depozitave në vitet 2003 – 2016, bazuar në nenin 52, të ligjit 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, si më poshtë vijon:

i. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti kanë mungesë burimesh financiare të ligjshme ndër vite, për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve.

**3.4** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, dërgoi shpjegime dhe prova<sup>39</sup> për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, si më poshtë vijon:

i. Në lidhje me llogarinë nr. \*\*\*, në emër të fëmijës A.P. nuk është kryer asnjë tërheqje. Depozitimi fillestar është në shumën 40.000 lekë (mbledhur nga urimet e familjarëve dhe njerëzve të afërt), data e hapjes së llogarisë, është rreth 4 muaj pas ardhjes në jetë të fëmijës. Depozitimet në vijim, në këtë llogari bankare, janë bërë duke kursyer afërsisht 10.000 lekë çdo muaj dhe duke i derdhur herë pas here sipas kësaj radhe: depozitimi i dytë, datë 15.8.2004, në vlerën 40.000 lekë (4 muaj = 40.000 lekë); depozitimi i tretë, datë 23.1.2004, në vlerën 40.000 lekë (4 muaj = 40.000 lekë); datë 1.4.2004, gjeneruar interes 6.462 lekë; datë 30.4.2004, depozitim 30.000 lekë (3 muaj = 30.000 lekë); datë 3.9.2004, depozitim 50.000 lekë (5 muaj = 50.000 lekë); datë 7.12.2004 depozituar 40.000 lekë (3 muaj = 30.000 lekë + 10.000 lekë nga urimet e ditëlindjes = 40.000 lekë); datë 1.4.2005, gjeneruar interes 14.600 lekë; datë 22.7.2005, depozitim 70.000 lekë (7 muaj = 70.000 lekë); datë 23.1.2006, depozitim 50.000 lekë (5 muaj = 50.000 lekë); datë 1.4.2006, gjeneruar interes 20.720 lekë; depozitimi tjetër është në datën 4.10.2006, në vlerën 40.000 lekë, pra, nuk ka qenë e mundur të depozitoheshin 10.000 lekë/muaj, por më pak; datë 14.11.2006, depozitim në vlerën

<sup>37</sup>Nxjerrje llogarie në “Intesa Sanpaolo Bank”, në lekë, në emër të shtetasës A.P., për periudhën 1.1.2003 – 20.1.2017, me balancë në shumën 1.243.760 lekë; nxjerrje llogarie në “Intesa Sanpaolo Bank”, në lekë, në emër të shtetasit M.P., për periudhën 1.1.2005 – 20.1.2017, me balancë në shumën 681.933 lekë.

<sup>38</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.8.2019.

<sup>39</sup> Subjekti ka paraqitur: *statement* për llogarinë nr. \*\*\*, për periudhën 16.4.2003 – 26.12.2019 dhe *statement* për llogarinë nr. \*\*\*, për periudhën 22.7.2005 – 26.12.2019.

10.000 lekë; datë 1.4.2007, gjeneruar interes 24.469 lekë; datë 8.6.2007, depozitim 70.000 lekë (7 muaj=70.000 lekë); datë 30.11.2007, depozitim 50.000 lekë (5 muaj = 50.000 lekë); datë 1.4.2008, gjeneruar interes 38.101 lekë; datë 19.5.2008, depozitim 70.000 lekë (7 muaj = 70.000 lekë); datë 1.4.2009, gjeneruar interes 50.117 lekë; datë 1.4.2009, depozitim 40.000 lekë; prej datës 1.4.2009 kur është bërë depozitimi 40.000 lekë, gjithë depozitimet në vijim kanë qenë jashtë rregullit 1 muaj = 10.000 lekë.

- ii. Në lidhje me llogarinë nr. \*\*\*, në emër të fëmijës **M.P.**, subjekti deklaroi se nuk është kryer asnjë tërheqje. Data e hapjes së llogarisë është dy muaj pas ardhjes në jetë të fëmijës së dytë, në shumën 20.000 lekë (mbledhur nga urimet e familjarëve dhe njerëzve të afërt). Depozitimet në vijim, në këtë llogari bankare, janë bërë duke kursyer afërsisht 10.000 lekë çdo muaj dhe duke i derdhur herë pas here sipas kësaj radhe: depozitimi i dytë datë 23.1.2006, në vlerën 50.000 lekë (5 muaj = 50.000 lekë); datë 1.4.2006, gjeneruar interes 1.467 lekë; depozitim datë 14.11.2006, në vlerën 50.000 lekë + depozitim datë 26.3.2007, në vlerën 70.000 lekë (12 muaj = 120.000 lekë); datë 1.4.2006, gjeneruar interes 5.410 lekë; depozitim datë 11.10.2007, në vlerën 50.000 lekë; depozitim datë 30.11.2007, në vlerën 50.000 lekë + depozitim datë 19.5.2008, në vlerën 20.000 lekë (12 muaj=120.000 lekë); datë 31.3.2008, gjeneruar interes 1.656 lekë; datë 1.4.2009, depozitim në vlerën 30.000 lekë (nuk është ruajtur rregulli çdo muaj 10.000 lekë), gjeneruar interes 23.909 lekë; prej datës 1.4.2009 kur është bërë depozitimi 30.000 lekë, gjithë depozitimet në vijim kanë qenë jashtë rregullit 1 muaj = 10.000 lekë.
- iii. Pas fillimit të vitit 2009 dhe në vazhdim në vitet 2010, 2011, 2012, 2013, 2014 dhe 2015 depozitimet janë në vlera të vogla dhe tepër të çrregullta, të realizuara nga të hollat që gjyshërit përkatës të fëmijëve u kanë dhuruar, me raste festash apo ditëlindjesh, ndërkohë që subjekti dhe personi i lidhur nuk kishin mundësi të kontribuonim për shkak se iu nënshtruan për disa vite rresht, procesit penal të ngritur ndaj tyre.

## **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**3.5** Komisioni, pas analizimit të mundësive financiare për krijimin e këtyre depozitave, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti, kanë mungesë burimesh financiare të ligjshme ndër vite, për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve.

### **4. Llogari në lekë dhe në USD, në “Intesa Sanpaolo Bank”**

**4.1** Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se disponon llogari në lekë dhe në USD në “Intesa Sanpaolo Bank”, të hapura në vitin 2014, me gjendje deri në datën 20.1.2017, në shumat: 141.232,09 lekë, 1.220 USD dhe 10.000 lekë. Si burim krijimi subjekti deklaroi se: *“Llogaritë në USD dhe lekë janë krijuar dhe administruar sipas vullnetit të prindërve në kushtet që banojnë në SHBA, (të dyja llogaritë janë krijuar pas transferitës 9.497,39 USD, për arsye largimi jashtë shtetit të motrës) znj. L.B.Gj., e cila administronte deri para largimit të saj këtë shumë që i përkiste prindërve”*. Prindërit e subjektit janë larguar me banim jashtë Shqipërisë që prej vitit 2008, dhe për vërtetimin e deklarimeve ka paraqitur dokumentacion ligjor provues<sup>40</sup>.

<sup>40</sup>Nxjerrje llogarie në “Intesa Sanpaolo Bank”, në USD, në emër të shtetases Marsela Balili, për periudhën 1.1.2014 – 20.1.2017, me balancë në shumën 1.220 USD; nxjerrje llogarie në “Intesa Sanpaolo Bank”, në lekë, në emër të shtetases

## **Në lidhje me përputhshmërinë e deklaramit**

**4.2** Nisur nga dokumentacioni i administruar nga banka <sup>41</sup>, konfirmohet se subjekti i rivlerësimit zotëron llogari në “Intesa Sanpaolo Bank”, në lekë dhe në USD. Gjendja e llogarive në datën 20.1.2017 është në vlerën 141.232,09 lekë, në llogarinë nr. \*\*\*; në vlerën 10.000 lekë, në llogarinë nr. \*\*\* (kartë krediti e parapaguar) dhe në vlerën 1.220,02 USD, në llogarinë nr. \*\*\*.

### **Komisioni, nga hetimi i burimit të krijimit, konstatoi se:**

**4.3** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014, subjekti deklaroi transfertë nga llogaria bankare e motrës, znj. L.B. (Gj.), në llogarinë e saj në “Intesa Sanpaolo Bank”, në datën 31.3.2014, në shumën 9.497,39 USD. Burimi i krijimit: shuma i përket prindërve V. dhe P.B. Llogaria e krijuar nga transfertat është pakësuar sipas vullnetit të prindërve dhe deri në datën 31.12.2014, gjendja rezultoi 403.065,91 lekë.

**4.4** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, subjekti deklaroi se llogaria në lekë dhe USD në “Intesa Sanpaolo Bank” deri në datën 20.1.2017 rezultoi në shumën 141.232,09 lekë, 10.000 lekë dhe 1.220 USD. Burimi i krijimit: llogaritë janë krijuar dhe administruar sipas vullnetit të prindërve, që banojnë në SHBA (të dyja llogaritë janë krijuar pas transfertës në vlerën 9.497,39 USD, për arsye të largimit jashtë shtetit të motrës së subjektit, znj. L.B.Gj., e cila administronte deri para largimit të saj shumën që i përkiste prindërve, të cilët janë larguar me banim në SHBA, që prej vitit 2008).

**4.5** Në pyetësoin nr. 2, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të vërë në dispozicion dokumentacionin ligjor justifikues për të ardhurat që kanë shërbyer si burim për krijimin e shumës 9.497,39 USD, si dhe të shpjegojë se për çfarë është përdorur shuma e tërhequr.

**4.6** Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se shuma prej 9.497,39 USD u përkiste prindërve, e krijuar nga të ardhurat e punësimit të tyre në SHBA. Meqenëse motra e subjektit, znj. L.B., do të largohej përfundimisht nga Shqipëria, shuma prej 9.497,39 USD iu transferua subjektit dhe u përdor për shpenzime jetese.

**4.7** Komisioni, nga hetimi administrativ kryesisht, arriti në rezultatin se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar. Burimi i ligjshëm i shumës 9.497,39 USD, do të trajtohet më poshtë, në pikën 5.

## **5. Shumat e transfertave bankare nga personi tjetër i lidhur/babai i subjektit të rivlerësimit**

**5.1** Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Shumat e transfertave bankare të deklaruara në vitin e fundit në deklarinë vjetore në ILDKPKI, të mbërritura me transfertën bankare SHBA-Shqipëri, prej urdhëruesit P.B., përkatësisht shumën: 29.969 USD, transferuar në datën 23.6.2015 dhe 16.469 USD, transferuar në datën 10.12.2015, janë kaluar me llogarinë bankare në BKT Vlorë, si këst i parë dhe këst i dytë për*

---

Marsela Balili, për periudhën 1.1.2014 – 20.1.2017, me balancë në shumën 0 lekë; nxjerrje llogarie në “Intesa Sanpaolo Bank” me nr. \*\*\*, në lekë, në emër të shtetases Marsela Balili, për periudhën 1.1.2014 – 20.1.2017, me balancë në shumën 141.232 lekë; nxjerrje llogarie në “Intesa Sanpaolo Bank”, në lekë, në emër të shtetases Marsela Balili, për periudhën 1.1.2014 – 20.1.2017, balancë në shumën 10.000 lekë.

<sup>41</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.8.2019.

blerje apartament banimi në Vlorë, në pronësi të prindërve P. dhe V.B., në shumën totale 35.000 euro (kontratë paraprake shitjeje nr. \*\*\*, datë 9.1.2017)”. Si burim krijimi subjekti deklaroi: “Të ardhura nga punësimi i prindërve që jetojnë në SHBA (në këtë marrëdhënie kam vepruar si përfaqësuese me prokurë e prindërve)”. Pjesa takuese: 0 %. Për vërtetimin e deklaramëve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues<sup>42</sup>.

### **Në lidhje me përputhshmërinë e deklaramit**

**5.2** Nisur nga dokumentacioni i administruar nga ASHK-ja Vlorë<sup>43</sup>, rezultoi pasuri e paluajtshme në bashkëpronësi e regjistruar në favor të personave të tjetër të lidhur, P. dhe V.B. (prindërit e subjektit), me sip. 29 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*. Gjithashtu, z. P.B. rezultoi aplikues në procesin e legalizimit nr. \*\*\* prot., datë 9.11.2006, për ndërtim pa leje në Vlorë.

**5.3** Subjekti i rivlerësimit, në pyetësorin standard deklaroi se kjo pasuri nuk është e regjistruar në ZVRPP-në Vlorë. Për sa më sipër, apartamenti i blerë me kontratën paraprake nr. \*\*\*, datë 9.1.2017, nuk figuron ende i regjistruar në emër të personave të tjerë të lidhur/prindërit e subjektit, P. dhe V.B.

### **Nga hetimi i Komisionit u konstatua**

**5.4** Në deklaratën “Vetting”, subjekti deklaroi se në datën 23.6.2015, është transferuar shuma 29.969 USD nga banka përkatëse në SHBA, nga personi tjetër i lidhur, z. P.B. Nisur nga analizimi i deklaramëve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar nga Komisioni, konstatohet se: (i) në lidhje me transfertën e parë prej 29.969 USD - subjekti i rivlerësimit ka tërhequr shumën 25.000 USD dhe ka depozituar në llogarinë e saj shumën prej 20.000 euro, në datën 1.7.2015, në BKT. Më tej, konstatohet se subjekti ka transferuar këtë shumë për llogari të z. P.B., si kësti i parë për blerje apartament banimi në pronësi të prindërve; (ii) në lidhje me transfertën e dytë prej 16.469 USD – subjekti i rivlerësimit ka tërhequr shumën prej 16.450 USD, dhe ka depozituar në llogarinë e saj shumën prej 15.000 euro, në BKT. Më tej, konstatohet se subjekti e ka transferuar këtë shumë për llogari të z. P.B., si këst i dytë për blerje apartament banimi në pronësi të prindërve.

**5.5** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, subjekti deklaroi se janë paguar 35.000 euro me qëllim blerjen e apartamentit në Vlorë, sipas kontratës së shitjes paraprake nr. \*\*\*, datë 9.1.2017, në pronësi të personave të tjerë të lidhur/prindërve të subjektit. Burimi i krijimit: të ardhurat nga punësimi i prindërve që jetojnë në SHBA, subjekti deklaroi se ka vepruar si përfaqësuese me prokurë e prindërve.

**5.6** Subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Veting” ka dorëzuar kontratën paraprake të shitblerjes sendit të ardhshëm nr. \*\*\*, datë 9.1.2007, lidhur ndërmjet shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., përfaqësuar nga z. P.B. dhe palë blerëse personat e tjerë të lidhur/P. dhe V.B., përfaqësuar me prokurë nga subjekti i rivlerësimit. Objekti i kësaj kontrate është blerja e apartamentit 2+1, me sip. totale

---

<sup>42</sup> Kontratë paraprake shitblerjeje e sendit të ardhshëm me nr. \*\*\*, datë 9.1.2017, me objekt shitjen e apartamentit me sip. totale 87.6 m<sup>2</sup>, i ndodhur në Vlorë, me çmim blerjeje në shumën 35.000 euro, dy transfera nga llogaria në llogari të kryera në BKT në datën 22.12.2015, në shumën 15.000 euro dhe në datën 1.7.2015, në shumën 20.000 euro, me qëllim pagesën për blerje apartamenti në pronësi të shtetasve P. dhe V.B.; leje ndërtimi për shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., nr. \*\*\*, datë 28.9.2011, leje ndërtimi për shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., nr. \*\*\*, datë 24.2.2009; prokurë e posaçme me nr. \*\*\* kol., datë 25.1.2016; prokurë e posaçme me nr. \*\*\*, datë 12.5.2015, deklaratë noteriale nr. \*\*\* kol., datë 11.8.2015, nxjerrje llogarie në “Intesa Sanpaolo Bank”, në USD, në emër të shtetasës Marsela Balili, për periudhën 1.1.2014 – 20.1.2017, me balancë në shumën 1.220 USD.

<sup>43</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 24.9.2019.

87.6 m<sup>2</sup> dhe sip. funksionale 81.3 m<sup>2</sup>, në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë. Vlera e shitjes së apartamentit është 35.000 euro. Sipas kontratës, pala blerëse ka likuiduar totalisht shumën: (i) kësti në vlerën 20.000 euro është likuiduar nga përfaqësuesja e palës, subjekti i rivlerësimit në datën 1.7.2015, në BKT; (ii) kësti 15.000 euro, është likuiduar nga përfaqësuesja e palës, subjekti i rivlerësimit në datën 22.12.2015, në BKT; (iii) përfaqësuesja e palës blerëse, subjekti i rivlerësimit, znj. Marsela Balili, ka nënshkruar një deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 11.8.2015, me investitor z. E.B., për vërtetimin e këstit të parë të paguar për blerjen e apartamentit; (iv) palët deklarojnë se vlera e shitjes së apartamentit ka kaluar në llogarinë bankare të përfaqësuesit të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., z. P.B., si investitor në objekt; (v) sipas akordit të palëve, apartamenti do të dorëzohet në datën 31.12.2015, mbasi është bërë pagesa e këstit të fundit.

**5.7** Referuar prokurës së posaçme nr. \*\*\*, datë 25.1.2016, z. F.K., në cilësinë e administratorit të shoqërisë sipërmarrëse “\*\*\*\*” sh.p.k., cakton shtetasin P.B., të bëjë nënshkrimin e kontratave të prenotimit në objektin në lagjen “\*\*\*\*” Vlorë, dhe të arkëtojë shumat që rrjedhin nga kontrata e prenotimit në llogarinë e tij në qoftë se dëshiron, ose t’i përdorë për nevoja të tjera që mund të lindin në lidhje me hipotekimin e objektit.

**5.8** Referuar prokurës së posaçme nr. \*\*\*, datë 12.5.2015, personat e tjerë të lidhur/P. dhe V.B., emërojnë përfaqësues të tyre subjektin e rivlerësimit, znj. Marsela Balili, të cilën e autorizojnë të kryejë çdo veprim në “Bankën Kombëtare Tregtare”, në llogaritë e tyre dhe të nënshkruajë çfarëdolloj kontrate blerjeje në emër të tyre për pasuritë e paluajtshme.

**5.9** Referuar deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 11.8.2015, me palë znj. Marsela Balili dhe investitorin, z. E.B., citohet se subjekti i rivlerësimit, në qershor të vitit 2015, i ka dhënë investitorit, z. E.B., shumën prej 20.000 euro, për blerjen e apartamentit të ndodhur në Vlorë. Investitori, z. E.B., deklaroi se këtë vlerë monetare e ka marrë si pagesë e këstit të parë të apartamentit me vlerë totale 35.000 euro.

**5.10** Më qëllim analizimin e vlerës së blerjes së këtij apartamenti dhe nëse ka pasur apo jo ndonjë trajtim preferencial për subjektin, Komisioni, referuar udhëzimit nr. 4, datë 30.9.2015, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2015”, analizoi vlerën reale të tregut, e cila përlllogaritet në shumën 4.829.220 lekë (81.3 m<sup>2</sup> x 59.400 lekë/m<sup>2</sup>), apartamenti është blerë në shumën 4.858.750 lekë.

**5.11** Më tej, nga hetimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë<sup>44</sup>, nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit me shitësit/ndërtuesit e këtij apartamenti.

**5.12** Në pyetësin nr. 1 dhe 2, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues në lidhje me të ardhurat e prindërve në SHBA, specifikisht iu kërkua të vërë në dispozicion deklaratat vjetore të tyre të të ardhurave në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (*annual income tax return*), për periudhën 2008 – 2015 dhe lëvizjet e llogarive bankare nga ku janë kryer transfertat e mësipërme.

**5.13** Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit dorëzoi: (1) deklaratat vjetore të të ardhurave vetëm për vitet 2010 – 2014 dhe 2016 – 2018 (dhe jo për vitet 2008, 2009 dhe 2015); (2) lëvizjet e dy llogarive bankare; dhe (3) vërtetim nga punëdhënësi për datën e fillimit të punësimit dhe pagën orare të babait.

---

<sup>44</sup> Shkresë nr. \*\*\*, datë 2.12.2019.

**5.14** Komisioni përllorarit të ardhurat e përfituara nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, me qëllim përcaktimin e mundësive financiare për transferimin e shumave në vlerën totale 46.500 USD, për blerjen e apartamentit në Vlorë dhe shumën e transferuar nga znj. L.B. në vlerën 9.497,39 USD.

**5.15** Për sa më sipër, u analizuan deklaratat vjetore të të ardhurave për vitet 2010 – 2014, ku konstatohet se të ardhurat *neto* për periudhën 2010 – 2014, kanë qenë në shumën 80.377,43 USD.

**5.16** Gjithashtu, Komisioni analizoi llogaritë bankare të prindërve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me transaksionet e kryera në llogarinë bankare me nr. \*\*\*, për periudhën 17.3.2013 – 16.9.2015 dhe 16.12.2015 – 31.12.2015, dhe në llogarinë bankare me nr. \*\*\*, për periudhën 8.3.2013 – 7.12.2015.

**5.17** Transfertat e kryera në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit për blerjen e apartamentit në Vlorë, në shumën 46.500 USD, janë kryer nga gjendja e mbetur në llogarinë bankare. Ndërkohë, për shumën e transferuar nga motra e subjektit, znj. L.B., nuk ka evidencë nëpërmjet llogarive bankare të prindërve.

**5.18** Komisioni vëren se prindërit e subjektit kanë të ardhura mesatare vjetore në shumën 16.075 USD (deklaratat vjetore të të ardhurave në shumën 80.377,43 USD/5 vite).

**5.19** Në përlloraritjet e Komisionit nuk janë përfshirë të ardhurat e përfituara gjatë viteve 2008, 2009, 2015, pasi subjekti i rivlerësimit nuk dorëzoi deklaratat vjetore të të ardhurave për këto vite. Subjekti i rivlerësimit dorëzoi një vërtetim nga punëdhënësi, ku specifikohet se personi tjetër i lidhur/babai, është i punësuar në kompaninë “\*\*\*\*” prej periudhës 8.5.2008 e në vazhdim, me pagë orare 8.55 USD.

**5.20** Në analizë të sa më lart, duket se personat e tjerë të lidhur mund të kenë pasur mundësi të krijojnë të ardhura nga burime të ligjshme. Gjithsesi, ky konkluzion bazohet vetëm në të ardhurat e personave të tjerë të lidhur, duke mos llogaritur as shpenzimet minimale jetike të këtyre personave.

**5.21** Bazuar në nenin 52, të ligjit 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, si më poshtë vijon:

- i. Duket se subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” nuk ka deklaruar përdorimin e këtij apartamenti gjatë sezonit veror.

**5.22** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, dërgoi shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, si më poshtë vijon:

- i. Ky apartament nuk është përdorur në vitin 2015, kur janë bërë shlyerjet e kësteve, por është përdorur në sezonin veror të vitit 2016 (disa ditë në muajin gusht), ndërkohë që deklarata “Vetting” është dorëzuar vetëm 5 muaj më pas, në datën 29.1.2017. Duke qenë se ky apartament është përdorur vetëm disa ditë në gusht të vitit 2016 dhe ishte i pamobiluar, nuk është përmendur në deklaratën “Vetting”.

**Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**



**5.23** Komisioni çmon se duke mosdeklaruar përdorimin e këtij apartamenti gjatë sezonit veror, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm dhe të pasaktë të pasurive. Referuar pikës 11, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit mbart detyrimin të deklarojë të gjitha pasuritë e akumuluar ndërr vite, deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në zotërim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur.

## **6. Llogari në lekë në “Bankën Kombëtare Tregtare” me titullarë të llogarive prindërit e subjektit, P. dhe V.B.**

**6.1** Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: llogari në lekë në BKT, me titullarë të llogarive prindërit, P. dhe V.B., llogari të cilat i administron si përfaqësuese e tyre me prokurë. Gjendja në llogari deri në datën 27.1.2017, është në shumat 50.746 lekë, z. P.B. dhe 76.950,48 lekë, znj. V.B. Pjesa takuese: 0 %. Si burim krijimi subjekti deklaroi: derdhje e pensione nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Vlorë. Vlera: 50.746 lekë dhe 76.950,48 lekë. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues<sup>45</sup>.

### **Në lidhje me përputhshmërinë e deklaramit**

**6.2** Nga dokumentacioni i administruar nga banka<sup>46</sup>, konfirmohet se babai i subjektit të rivlerësimit zotëron llogari në BKT, ku gjendja e llogarisë në datën 27.1.2017 është në vlerën 50.746 lekë. Gjithashtu, konfirmohet se nëna e subjektit të rivlerësimit zotëron llogari në BKT, ku gjendja e llogarisë në datën 27.1.2017 është në vlerën 76.950,48 lekë. Konstatohet se kreditimet në llogaritë e mësipërme vijnë nga pensionet.

**6.3** Nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar.

## **7. Motoçikletë e tipit “PEGASUS”, viti i prodhimit 2007, me targa \*\*\***

**7.1** Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron një motoçikletë të tipit “PEGASUS”, blerë në vlerën 120.000 lekë, vit prodhimi 2007, me targa \*\*\*, pa kabinë, për përdorim vetjak, në emër të bashkëshortit, z. A.P. Pjesa takuese: 50 %. Si burim krijimi subjekti deklaroi: blerë për arsye të harxhimit ekonomik të karburantit, me të ardhura personale në vitet e penalizimit si bashkëshortë. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues<sup>47</sup>.

### **Në lidhje me përputhshmërinë e deklaramit**

<sup>45</sup>Nxjerrje llogarie pensioni nga BKT-ja, në emër të shtetasit P.B., në lekë, për periudhën 1.1.2015 – 27.1.2017, me balancë në shumën 50.746 lekë; nxjerrje llogarie pensioni nga BKT-ja, në emër të shtetasit V.B., në lekë, për periudhën 1.1.2015 – 27.1.2017, me balancë në shumën 76.950 lekë, prokurë e posaçme nr. \*\*\*, datë 12.5.2015.

<sup>46</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 16.8.2019.

<sup>47</sup> Certifikata e pronësisë nr. \*\*\*, lëshuar në datën 8.8.2012, për mjedin tip “PEGASUS”, në pronësi të shtetasit A.P., me targa \*\*\*.

**7.2** Nga dokumentacioni i administruar nga DRSHTRR-ja<sup>48</sup>, rezulton se mjeti me targa \*\*\* është në pronësi të personit tjetër të lidhur, z. A.P. Nga dokumentacioni i administruar nga ILDKPKI-ja<sup>49</sup>, rezulton se çmimi i blerjes është 130.000 lekë dhe jo 120.000 lekë, sipas deklaratës së subjektit. Mjeti me targa \*\*\*, është blerë nga personi i lidhur, z. A.P., në datën 13.3.2012, me faturën tatimore nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në vlerën 130.000 lekë. Certifikata e kontrollit fizik të mjetit konfirmon se shtetasi A.P. ka kryer kontrollin e mjetit në datën 2.8.2012.

**7.3** Nga këqyrja e AMF-së rezulton se personi i lidhur, z. A.P., ka prerë policën e sigurimit për këtë mjet deri në datën 5.9.2018.

**7.4** Për sa më sipër, Komisioni konstaton se nuk përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, si dhe subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar blerjen e këtij mjeti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, por vetëm në deklaratën “Vetting”.

### **Të dhëna të tjera gjatë hetimit**

**7.5** Nisur nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni dhe ILDKPKI-ja, në pronësi të personit të lidhur, z. A.P., rezulton edhe mjeti tip motorr me targa \*\*\*, blerë në vlerën 54.000 lekë, në datën 24.10.2011, me faturë tatimore nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. Evidentohet se personi i lidhur, z. A.P., ka kryer pagesën e gjobës prej 1.000 lekësh, në datën 11.6.2018, për tejkalim të afatit të kontrollit teknik vjetor.

**7.6** Nga këqyrja e AMF-së nuk rezultuan polica sigurimi për këtë mjet.

**7.7** Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar blerjen e mjetit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 dhe as në deklaratën “Vetting”.

**7.8** Nga faktet e analizuar më lart, bazuar në nenin 52, të ligjit 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, si më poshtë vijon:

- i. nuk përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, pasi referuar faturës së paraqitur nga DRSHTRR-ja Tiranë, çmimi i blerjes është 130.000 lekë dhe jo 120.000 lekë, sipas deklaratës së subjektit.
- ii. subjekti nuk e ka deklaruar blerjen e motomjetit me targa \*\*\*, në pronësi të personit të lidhur, z. A.P., në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, por vetëm në deklaratën “Vetting”.
- iii. subjekti nuk ka e deklaruar blerjen e motomjetit me targa \*\*\*, në pronësi të personit të lidhur, z. A.P., në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, dhe as në deklaratën “Vetting”.

**7.9** Subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit shpjegoi, si më poshtë vijon:

---

<sup>48</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.8.2019.

<sup>49</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 31.5.2018 dhe e-mail datë 17.5.2018.

- i. për sa i takon çmimit të blerjes së motoçikletës me targa \*\*\*, vlera e saktë është 130.000 lekë, por në deklarinimin e dhënë, subjekti nuk e ka pasur fizikisht faturën e blerjes dhe me përafërsi ka dhënë vlerën 120.000 lekë.
- ii. më tej, subjekti sqaroi se nuk ka pasur për qëllim mosdeklarimin e mjeteve. Koha e blerjes së motoçikletës së parë dhe të dytë korrespondon me fundvitin 2011 dhe fillimvitin 2012. Mospërmendja në deklarinimin e vitit 2012 është thjesht pakujdesi, por jo qëllim për ta fshehur, ndërkohë që të gjitha veprimet e blerjes dhe shitjes janë bërë të hapura dhe të dokumentuara me kontrata noteriale<sup>50</sup>.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**7.10** Komisioni çmon se subjektin i rivlerësimit me mosdeklarimin e dy motomjeteve me targa \*\*\* dhe \*\*\*, ka kryer deklarime të pamjaftueshme dhe të pasakta të pasurisë ndër vite, referuar pikës 11, nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit mbart detyrimin të deklarojë të gjitha pasuritë e akumuluar ndër vite, deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në zotërim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur.

## **PASURITË E PERSONIT TË LIDHUR/BASHKËSHORTIT TË SUBJEKTIT**

### **8. Llogari në lekë në Bankën Kombëtare Tregtare**

**8.1** Në deklaratën “Vetting” personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar se: *“Nuk disponoj asnjë pasuri tjetër veçmas, përveç sa është deklaruar nga bashkëshortja Marsela Balili, në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit. Disponoj vetëm vlerën prej 5.032 lekësh, deri në datën 27.1.2017, në llogarinë e hapur në BKT, për aktivitetin si person fizik i vetëpunësuar i vetëm”*. Vlera: 5.032 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Subjekti nuk ka bashkëlidhur në deklaratë dokumentacion justifikues.

**8.2** Në dokumentacionin e administruar nga BKT-ja <sup>51</sup>, konfirmohet se personi i lidhur/bashkëshorti zotëron llogari në BKT, si person fizik dhe gjendja e llogarisë është 5.032 lekë në datën 27.1.2017.

**8.3** Nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në rezultatin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar.

### **Konstatime të tjera nga hetimi i Komisionit**

**9.** Në deklaratën e interesave private të vitit 2004, personi i lidhur, z. A.P., ka deklaruar zotërimin e automjetit tip “BMW”, blerë në shumën 500.000 (dogana + shpenzime të tjera) lekë, viti i prodhimit 1993, me targa \*\*\*.

<sup>50</sup> Kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 28.8.2012 dhe kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 11.6.2018.

<sup>51</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.10.2019.

**9.1** Rezulton se në deklaratat vjetore të mëvonshme nuk janë deklaruar ndryshime për këtë pasuri, ndërkohë që në deklaratën “Vetting”, ky automjet nuk është deklaruar.

**9.2** Nga dokumentacioni i administruar nga DRSHTRR-ja<sup>52</sup>, lidhur me këtë automjet, rezulton se është lidhur kontrata e dhurimit nr. \*\*\*, datë 10.4.2004, sipas së cilës dhuruesi A.S., shtetas gjerman, i dhuron personit të lidhur, z. A.P., automjetin tip “BMW”.

Sipas deklaratës doganore, datë 8.6.2004, ky automjet ka kushtuar 300.000 lekë + shpenzimet 193.447 lekë = 493.447 lekë.

**9.3** Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 2, kërkoi nga subjekti i rivlerësimit shpjegime dhe dokumentacionin ligjor në lidhje me statusin aktual të pronësisë mbi këtë automjet.

Në përgjigje<sup>53</sup>, subjekti i rivlerësimit deklaron se në vitin 2003 bashkëshorti i saj ka qenë i punësuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin, dhe nevojat për lëvizje i mbulonte me një automjet tip “BMW”, model i vjetër 324. Në vitin 2004 bashkëshorti filloi të përdorte automjetin tip “BMW”, me targa \*\*\*, vit prodhimi 1993, i cili më vonë ka dalë jashtë përdorimit dhe ka përfunduar për skrap. Targat e automjetit, për neglizhencë, nuk janë dorëzuar në kohën e duhur për të kryer ç’regjistrimin e automjetit te autoritetet përkatëse. Subjekti paraqiti vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 11.11.2019, lëshuar nga DRSHTRR-ja, i cili vërteton heqjen e përhershme nga qarkullimi në datën 31.12.2017, e automjetit tip “BMW”, me targa \*\*.

**9.4** Në pyetësorin nr. 2, subjekti deklaron se në vitin 2012, nevojat për lëvizje filluan të plotësohen me automjetin tip “Ford Fiesta”, më pas, në maj të vitit 2018 janë pajisur me automjetin tip “Chevrolet Captiva”. Gjithashtu, në pyetësorin standard, subjekti i rivlerësimit deklaroi blerjen e automjetit tip “Chevrolet Captiva”, në shumën 8.000 euro, në datën 5.5.2018, deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2018. Pagesa e çmimit të automjetit është realizuar duke paguar shumën 2000 euro, nëpërmjet transfertës bankare nga llogaria në “Intesa Sanpaolo Bank” drejt llogarisë bankare të shoqërisë “\*\*\*\*”, kurse pjesa e mbetur prej 6.000 euro është paguar *cash* në momentin e marrjes në dorëzim të automjetit në datën 5.5.2018. Shuma prej 8.000 euro është krijuar nga shuma prej 1.500.000 lekësh, tërhequr në datën 3.5.2018, nga llogaria bankare e subjektit në “Intesa Sanpaolo Bank”. Subjekti, në mbështetje të deklarimeve, ka dorëzuar dokumentacion ligjor justifikues<sup>54</sup>.

**9.5** Gjatë hetimit rezultoi se personi i lidhur, z. A.P., në vitin 2003 lëvizte me një automjet tip “BMW”, model 324, të cilin nuk e ka deklaruar në deklaratimet vjetore periodike, ndërkohë, automjeti tip “BMW”, me targa \*\*\*, me vit prodhimi 1993, rezulton i modelit 325, blerë në vitin 2004.

**9.6** Nga dokumentacioni i administruar nga DRSHTRR-ja<sup>55</sup>, referuar deklaratës doganore rezulton se z. A.P. ka blerë automjetin tip “Chevrolet Captia”, në vlerën 8.000 euro (kursi i këmbimit 128.74) dhe shpenzime doganore 213.707 lekë. Pra, në total, automjeti ka kushtuar 1.029.920 lekë (8.000 euro x 128.74) + 213.707 lekë = 1243627 lekë.

---

<sup>52</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.8.2019.

<sup>53</sup> *E-mail-i* i datës 11.11.2019.

<sup>54</sup> *Statement* nga “Intesa Sanpaolo Bank”, ku pasqyrohet tërheqja e shumës prej 1,500,000.00 lekësh; kopje e transfertës bankare të shumës 2000 euro drejt llogarisë bankare të shoqërisë “\*\*\*\*”; kopje e faturës, datë 5.5.2018, që i përket blerjes së automjetit; kopje e faturës datë 5.5.2018, që i përket fjetjes së z. A.P., në hotelin \*\*\*, Gjermani.

<sup>55</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.8.2019.

**9.7** Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52, të ligjit 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimin shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, si më poshtë vijon:

- i. nuk përputhet deklarimi i subjektit lidhur me blerjen e automjetit tip “Chevrolet Captiva”, në shumën 8.000 euro (1.029.920 lekë) nga dokumentacioni i administruar. Ky automjet ka kushtuar 1.243.627 lekë.
- ii. personi i lidhur, z. A.P., në vitin 2003 lëvizte me një automjet tip “BMW”, model 324, të cilin nuk e ka deklaruar në deklaratimet periodike vjetore, ndërkohë automjeti tip “BMW”, blerë në vitin 2004, me targa \*\*\*, vit prodhimi 1993, rezulton i modelit 325.

**9.8** Subjekti i rivlerësimin për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit shpjegoi, si më poshtë vijon:

- i. deklarimi i shumës 8.000 euro, i referohet shitblerjes së realizuar me shoqërinë “\*\*\*”, shpenzimet doganore në vlerën 213.707 lekë nuk i ka referuar në deklarim, kjo shumë është paguar nga vlera prej 1.500.000 lekësh, tërhequr në datën 3.5.2018 në “Intesa Sanpaolo Bank”.
- ii. automjeti tip “BMW”, model 324, është i ndryshëm nga automjeti “BMW”, me targa \*\*\*, model 325. Automjeti model 324 është përdorur në vitin 2003 nga personi i lidhur, z. A.P., dhe është i vërtetë konstatimi i Komisionit se nuk është pasqyruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003. Ky automjet i përkiste një personi tjetër dhe nuk ka qenë i regjistruar në emër të personit të lidhur, z. A.P., por është përdorur prej tij, për këtë arsye nuk është pasqyruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003.
- iii. Automjeti tip “BMW”, me targa \*\*\*, vit prodhimi 1993, prej vitit 2012 doli nga qarkullimi, dhe nuk është deklaruar në deklaratën “Vetting”, pasi nuk ishte më në përdorim dhe pronësi të subjektit, që prej vitit 2012 kur përfundoi për skrap.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**9.9** Rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimin nuk ka deklaruar në deklaratimet vjetore periodike të vitit 2003, përdorimin nga personi i lidhur, z. A.P., të automjetit tip “BMW”, model 324. Në këto kushte subjekti ka kryer deklarime të pamjaftueshme dhe të pasakta të pasurisë ndër vite. Referuar pikës 11, nenit 3, e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimin mbart detyrimin të deklarojë të gjitha pasuritë e akumuluar ndër vite, deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në zotërim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimin apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur.

**10.** Gjatë hetimit, Komisioni konstatoi se në dokumentacionin e administruar nga “Tirana Bank”<sup>56</sup>, në llogarinë e personit të lidhur, z. A.P., në datën 14.9.2011, është transferuar shuma 84.000 euro, me përshkrimin “*transferim P.K., blerje pasurie e patundshme*”. Më tej, personi i lidhur, z. A.P., ka kryer tërheqjen e kësaj shume gjatë vitit 2012, të ndarë në disa veprime.

---

<sup>56</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 7.8.2019.

**10.1** Për sa më sipër, rezultoi se Komisioni hetoi më tej, lidhur me këtë veprim dhe nga dokumentacioni i administruar nga ASHK-ja Tiranë<sup>57</sup>, rezultoi se personi i lidhur, z. A.P., ka vepruar në cilësinë e përfaqësuesit të znj. E.L.L., me prokurën e posaçme nr. \*\*\*, datë 1.4.2010, për nënshkrimin e kontratës së shitjes me rezervë nr. \*\*\*, datë 9.6.2011, me objekt: “shitjen e apartamentit në pronësi të znj. E.L.L., kundrejt blerësit P.K.”. Ky apartament është shitur në vlerën 104.000 euro, sipas kontratës së shitjes me rezervë 20.000 euro janë likuiduar në momentin e lidhjes së kontratës në praninë e noteres, diferenca tjetër prej 84.000 euro, do të likuidohet nga blerësi deri në datën 12.12.2011.

Në deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 15.9.2011, lidhur ndërmjet shtetasit P.K. dhe shtetases E.L.L., përfaqësuar me prokurë nga personi i lidhur, z. A.P., vërtetohet se: “me anë të mandatpagesës së datës 14.9.2011, në ‘Tirana Bank’ është likuiduar vlera 84.000 euro, kundrejt përfaqësuesit të znj. E.L.L., e cili deklaron se e ka marrë këtë shumë dhe në këtë mënyrë është likuiduar plotësisht vlera e shitjes së apartamentit.”

\*\*\*

**11.** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, subjekti ka deklaruar 1/3 pjesë takuese të një apartamenti 1+1, të ndodhur në Vlorë, si rrjedhojë e privatizimit.

Ndërkohë, personi i lidhur, z. A.P., ka deklaruar: “*Si person madhor edhe të drejtën e trashëgimisë nga babai për apartamentin e regjistruar në emrin e tij dhe të privatizuar mbas vitit 1990, shtëpinë e lindjes në Përmet*”.

**11.1** Rezulton se subjekti dhe bashkëshorti, në deklaratimet e interesave private në vazhdim, nuk kanë deklaruar ndryshime mbi pronësinë e këtyre dy apartamenteve. Në deklaratën “Vetting” subjekti nuk i deklaroi dy apartamentet dhe nuk ka paraqitur dokumentacion mbi pronësinë e tyre.

**11.2** Nga dokumentacioni i administruar nga ZVRPP-ja Përmet<sup>58</sup> konfirmohet se: (i) në emër të z. Th.P., rezulton apartament me sip. 25.47 m<sup>2</sup>, vol \*\*\*, f. \*\*\*, në z. k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*, në Përmet; (ii) në emër të z. S.Th.P., rezulton apartament me sip. 20.84 m<sup>2</sup>, vol \*\*\*, f. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, në Përmet. Vërtetuar sa më sipër me kartelat e pasurisë, datë 22.8.2019. Ky apartament është përfutur me kontratë privatizimi datë 17.7.1993, me pagesë prej 3400 lekë/muaj.

**11.3** Nga dokumentacioni i administruar nga ZVRPP-ja Vlorë<sup>59</sup>, rezulton pasuri e paluajtshme në bashkëpronësi e regjistruar në favor të personave të tjetër të lidhur/P. dhe V.B., me sip. 29 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*. Gjithashtu, z. P.B. rezulton aplikues në procesin e legalizimit nr. \*\*\* prot., datë 9.11.2006, për ndërtim pa leje në Vlorë. Ky apartament është përfutur me kontratën e privatizimit nr. \*\*\*, datë 12.12.1994, me pagesë prej 4389 lekësh në muaj, vërtetuar kjo me certifikatën e pronësisë datë 29.3.2006.

**11.4** Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52, të ligjit 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën

<sup>57</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 11.11.2019.

<sup>58</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 26.8.2019.

<sup>59</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.9.2019.

e provës me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, si më poshtë vijon:

- i. subjekti dhe bashkëshorti, në deklaratimet e interesave private në vazhdim, nuk kanë deklaruar ndryshime mbi pronësinë e këtyre dy apartamenteve.
- ii. në deklaratën “Vetting” subjekti nuk i deklaroi këto dy apartamente dhe nuk ka paraqitur dokumentacion mbi pronësinë e tyre.

**11.5** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, dërgoi shpjegime dhe prova<sup>60</sup> për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, si më poshtë vijon:

- i. Në periudhën e privatizimit të banesave në vitin 1993, subjekti ka qenë në moshë madhore dhe për këtë arsye në kontratën e privatizimit, datë 29.12.1993, përveç kryefamiljarit, z. P.B., janë shënuar me shkrim dore si bashkëpronarë z. V.B. dhe znj. Marsela Balili. Më vonë, subjekti ka konstatuar se emri i saj nuk figuronte si bashkëpronare, për këtë arsye nuk e ka përmendur në deklaratimet në vijim, në deklaratën “Vetting”.
- ii. Personi i lidhur, z. A.P., ka qenë madhor në periudhën e privatizimit të apartamentit, të ndodhur në Përmet. Regjistrimi hipotekor ka mbetur me dy emra: z. S.Th.P. dhe z. Th.Th.P., për shkak të ndarjes për të përfutur bursë shkollimi, por asnjëherë personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, z. A.P., nuk ka ushtruar të drejta pronësie mbi këtë pjesë apartamenti dhe nuk është sjellë si pronar me të. Meqenëse ishte në dijeni të këtij veprimi, personi i lidhur/bashkëshort, z. A.P., për të qenë korrekt me deklarinin ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 se figuron bashkëpronar. Në vitet në vijim dhe në deklaratën “Vetting” nuk është përmendur kjo pronë në përputhje me të vërtetën *de facto*, se nuk ushtrojnë të drejta dhe nuk kanë tërhequr ndonjëherë të drejta pronësie nga kjo pronë.

## **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**11.6** Subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm faktin e mosdeklarimeve lidhur me ndryshimet mbi pronësinë e dy apartamenteve në deklaratimet e interesave private ndër vite, si dhe në deklaratën “Vetting”.

## **12. Analiza financiare sipas viteve 2003 – 2016**

**12.1** Komisioni, pasi kreu analizën financiare duke marrë në konsideratë pasuritë, të ardhurat, detyrimet dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, si më poshtë vijon:

- i. Për vitin 2010, duket se ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 836.199 lekë.
- ii. Për vitet 2011– 2012 duket se ka mungesë burimesh të ligjshme, si më poshtë:
  - Për blerjen e apartamentit *duplex*, mungesë 17.332.320 lekë.
  - Për blerjen e automjetit tip “Ford Fiesta”, mungesë 558.360 lekë (4.000 euro).

---

<sup>60</sup> Subjekti ka paraqitur: *statement* për llogarinë nr. \*\*\*, për periudhën 16.4.2203 – 26.12.2019, *statement* për llogarinë nr. \*\*\*, për periudhën 22.7.2005 – 26.12.2019.

- Për kryerjen e shpenzimeve të mobilimit, mungesë 3.070.980 lekë (22.000 euro).
- iii. Për vitin 2012 duket se ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 1.087.899 lekë.
- iv. Për vitin 2013, duket se ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 1.262.458 lekë.
- v. Për vitin 2015, duket se ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 1.311.646 lekë.

**12.2** Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, kërkoi të merren parasysh të ardhurat lidhur me periudhat: **1.** Periudha përpara vitit 2003: (i) bursa e shkollës së Magjistraturës; (ii) pagat e personit të lidhur me subjektin, përkatësisht në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Bulqizë, dhe me ndryshime sipas kthim përgjigjes së Prokurorisë së Kurbinit për periudhën 2000 – 2002; (iii) të ardhura nga prindërit përkatës, të subjektit dhe personit të lidhur në vlerën 300.000 lekë/secila palë, për shkak të mosorganizimit të ceremonisë martesore. **2.** Vitet 2003 – 2006: (i) ndryshimet në pagat e personit të lidhur në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin. **3.** Viti 2007: regjistruar si detyrim shuma 40.000 euro, kredi në “Raiffesen Bank” (regjistruar si shtim pasurie vetëm pjesa e parapagimit). **4.** Viti 2009: (i) të ardhurat nga mbështetja e familjarëve pas vitit 2009, për fëmijët në llogarinë “\*\*\* Intesa Bank” në shumën 90.000 lekë. Të gjitha depozitimet e viteve në vijim për llogarite “\*\*\*” të fëmijëve kanë qenë kontribut i familjarëve. **5.** Viti 2010 – 2016: (i) të ardhura nga mbështetja e familjarëve dhe puna informale në kushtet e goditjes së familjes nga shteti, përkatësisht në shumën e shpenzimeve të përditshme, këstit të kredisë në “Raiffeisen Bank” dhe pushime për periudhën 2010 – 2016. **6.** Viti 2011 – 2012: (i) shitja e ap. ekzistues me sip.72.5 m<sup>2</sup>, me vlerë 61.000 euro; (ii) pakësuar vlera e pasurisë me vlerën 3.647.384 lekë dhe diferenca prej 4.867.606 lekësh e regjistruar si e ardhur, ka shërbyer për pagesën e kësteve të apartamentit të ri *duplex*; (iv) shtesë pasurie pas firmosjes së kontratës së shitblerjes së apartamentit *duplex*, në shumën 12.889.830 lekë, si diferencë e vlerës së plotë prej 17.550.000 lekësh, me shumën e parapaguar në vitin 2007 prej 4.860.170 lekësh nga kredia; (v) kësti i fundit prej 10.000 euro, i regjistruar si detyrim në vijim ndaj shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k.; (vi) shuma 40.000 euro hua nga shtetasi M.M., shumë e cila mbulon pagesë kësti për apartamentin *duplex* 14.000 euro, pagesë blerje automjeti tip “Ford Fiesta” në vlerën prej 4.000 euro dhe rregullimin e mobilimit e apartamentit *duplex*, në shumën 22.000 euro; **7.** Viti 2014: (i) shuma prej 9,497.39 USD nga motra e subjektit, znj. L.Gj.B., depozituar në vitin 2014 shuma 900.000 lekë dhe gjendje *cash* shuma 194.384 lekë; **8.** Viti 2015: (i) zvogëlim *cash* në vlerën 194.384 lekë, shumë e mbetur nga depozitimi i viti 2014, diferencë nga shuma prej 9,497.39 USD nga motra e subjektit, znj. L.Gj.B.

**12.3** Në seancën dëgjimore të datës 13.1.2020, subjekti i rivlerësimit dorëzoi si dokumente shtesë dy fletë me shënime me shkrim dore, ku janë pasqyruar dhuratat në *cash* dhe në natyrë nga të afërm me rastin e lindjes së fëmijëve. Shuma totale është në vlerën 40.200 lekë.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**12.4** Në lidhje me të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni mori në konsideratë në analizë financiare: (1) të ardhurat nga bursa e subjektit në shumën 359.325 lekë<sup>61</sup>; (2) vërtetimi i ISSH-së Vlorë, për bazën e vlerësuar, periudha nëntor 2000 dhe prill

<sup>61</sup> Vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 23.12.2019, i Shkollës së Magjistraturës.



2001, të ardhura nga paga e subjektit në shumën 43.831 lekë, (llogaritur paga *neto* sipas legjislacionit që ka qenë në fuqi) në Gjykatën e Rrethit Vlorë; (3) të ardhurat nga paga e bashkëshortit të subjektit në shumën 721.399 lekë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan<sup>62</sup>; (4) të ardhura nga paga e bashkëshortit të subjektit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër, në shumën 379.712 lekë; (5) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 24.12.2019, universiteti “Ismail Qemali” Vlorë<sup>63</sup>, për të ardhurat e përfituara nga subjekti në korrik të vitit 2004 dhe në maj të vitit 2005, shuma totale 32.058 lekë; (6) të ardhura (transferte në USD – llog. bankare) nga motra e subjektit, znj. L.Gj.B., 9497.39 USD x 115.23 euro – janë evidentuar si ndihmë nga familjarët në pasqyrën e analizës financiare, pasi janë kaluar me rrugë bankare, transfertat është deklaruar në deklaratën periodike vjetore dhe është hetuar mbi mundësitë financiare të prindërve, të cilëve u përkiste kjo shumë.

**12.5** Në lidhje me të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, nuk janë konsideruar:

(1) të ardhurat nga paga në Prokurorinë e Rrethit Kurbini, në vlerën 74.315 lekë. Sipas përshkrimit në vërtetim, kjo shumë ka natyrën e dietës. Duke qenë se dietat janë vlera monetare të destinuara për të mbuluar shpenzimet e kryera gjatë një veprimtarie të caktuar, kjo shumë nuk është përfshirë në analizën financiare<sup>64</sup>; (2) të ardhurat në shumën totale 600.000 lekë, nga prindërit përkatës të subjektit dhe personit të lidhur, për shkak të mosorganizimit të ceremonisë martesore. Ky deklaram është bërë nga subjekti i rivlerësimit, vetëm pas kalimit të barrës së provës për justifikimin e burimit të blerjes së apartamentit me sip. 72.5 m<sup>2</sup>; (3) shuma prej 6,898,417 lekësh, si të ardhura nga mbështetja e familjarëve dhe puna informale në kushtet e goditjes së familjes nga shteti, për shumat e shpenzimeve të përditshme, këstit të kredisë me “Raiffeisen Bank” dhe pushimet për periudhën 2010 – 2016; (4) shuma prej 317.700 lekësh, si të ardhura nga mbështetja e familjarëve pas vitit 2009, për fëmijët në llogarinë “\*\*\* - Intesa Sanpaolo Bank”. Të ardhurat e deklaruara në pikën (3) dhe (4), nuk janë konsideruar në analizën financiare, pasi në deklaratat periodike vjetore përkatëse, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: të ardhura nga mbështetja e familjarëve dhe puna informale në kushtet e goditjes së familjes nga shteti, por nuk ka deklaruar vlera specifike siç kërkohet në rubrikën “dhurata dhe trajtime preferenciale”. Për më tepër, përveç shpenzimeve të këstit të kredisë, në tabelën e analizës financiare, subjekti i rivlerësimit ka vendosur si ndihmë nga të afërmit ekzaktësisht shumën e shpenzimeve jetike dhe të shpenzimeve për udhëtime, të përlllogaritura nga Komisioni. Shuma e shpenzimeve jetike është një vlerë statistikore e bazuar në shkresën e ILDKPKI-së, vlerë e cila nuk mundet që të jetë saktësisht e barabartë me shpenzimet e kryera realisht nga subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij. Po kështu, edhe shpenzimet për udhëtim janë bazuar në praktikën e përdorur nga Komisioni dhe do të ishte e pamundur që vlera e dhënë në formën e ndihmës nga të afërmit të ishte ekzaktësisht sa shuma e llogaritur nga Komisioni; (5) Të ardhurat (dhuratë cash) nga shtetasja Zh.S.M., teza e bashkëshortit të subjektit, për pushimet, në shumën 2.800 euro, nuk janë konsideruar në analizën financiare, për sa kohë që kryerja e kësaj pagese prej të afërmit nuk është deklaruar prej subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore, në rubrikën “dhurata dhe trajtime preferenciale”<sup>65</sup>; (6) regjistruar si zvogëlim cash në vlerën 194.384 lekë, shumë e mbetur nga depozitimi i vitit 2014, diferencë

<sup>62</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 24.12.2019, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

<sup>63</sup> Dorëzuar nga subjekti në seancën dëgjimore të datës 13.1.2020.

<sup>64</sup> Vendimi nr. \*\*\* (JR), datë 05.04.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

<sup>65</sup> Vendimi nr. \*\*\* (JR), datë 22.5.2019, f. \*\*\*, pika “\*\*\*”, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

nga shuma prej 9,497.39 USD, ekuivalent në lekë 1,094,384 nga motra e subjektit, znj. L.Gj.B., nuk është konsideruar në analizën financiare, pasi subjekti i rivlerësimit duhet ta kishte deklaruar këtë gjendje si likuiditetet cash në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014<sup>66</sup>; (7) pretendimet e subjektit se së bashku me bashkëshortin, nuk kanë pasur asnjë kosto jetese gjatë kohës që kanë jetuar te prindërit e saj, pasi shpenzimet e përlllogaritura janë në nivele minimale dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar dokumentacion justifikues për të ardhurat e prindërve.

**12.6** Për sa më sipër, rezulton se Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti, rezultojnë me **mungesë të ardhurash të ligjshme** për pasuritë, të ardhurat, detyrimet dhe shpenzimet e kryera në vitet 2010, 2011-2012<sup>67</sup>, 2013, 2014, 2015, 2016, të detajuara si në tabelën e mëposhtme:

VITI	Pasuri	Ndryshim likuiditete	Të ardhura	Detyrime	Shpenzime	Balanca
2003	-	157,536	1,098,672	-	851,592	89,544
2004	500,000	288,747	1,701,853	-	357,402	555,704
2005	-	699,836	1,694,755	-	375,456	619,463
2006	-	186,035	2,086,430	-	680,974	1,219,421
2007	17,550,000	- 973,334	2,169,892	22,410,170	954,060	7,049,336
2008	-	240,037	2,042,737	- 68,708	1,275,508	458,484
2009	-	321,852	1,349,471	- 95,169	953,401	-20,951
2010	-	- 10,097	86,902	- 141,808	791,391	-836,199
2011 - 2012	-	291,083	7,942,150	-17,621,398	5,366,379	-15,336,710
2013	-	95,042	95,114	- 160,166	927,806	-1,087,899
2014	-	501,607	1,168,707	- 61,357	773,816	-168,073
2015	-	297,969	44,543	- 26,439	1,031,781	-1,311,646
2016	-	- 235,462	239,289	32,187	1,106,756	-599,818
<b>TOTALI (2003-2016)</b>	<b>18,050,000</b>	<b>1,860,851</b>	<b>21,720,515</b>	<b>4,267,313</b>	<b>15,446,320</b>	<b>-9,369,343</b>

## ARSYETIMI LIGJOR DHE ANALIZA E ASETEVE DHE TË ARDHURAVE SË BASHKU

Trupi Gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit kalimtar “Vetting” të vitit 2017; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, si dhe deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; (iv) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit përmes postës elektronike; (v) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore; (vi) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim që të kuptohet më qartë raporti midis asetëve të

<sup>66</sup> Ligji nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve, dhe të disa nëpunësve publikë”.

<sup>67</sup> (1) Për blerjen e apartamentit duplex, mungesë 17.332.320 (124.000 Euro); (2) Për blerjen e automjetit Ford, mungesë 558.360 lekë (4.000 Euro); (3) Për kryerjen e shpenzimeve të arredimit, mungesë 3.070.980 lekë (22.000 Euro)

deklaruar dhe të ardhurave të ligjshme, si dhe analiza ligjore e veçantë për çdo aset, konkludon se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke bërë deklaram të rremë, duke fshehur burimin e vërtetë të krijimit të këtyre pasurive, duke bërë deklaram jo të saktë dhe në përputhje me ligjin dhe, për rrjedhojë, rezulton se ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë.
- ii. Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar në mënyrë të besueshme origjinën e ligjshme të pasurive të përmendura në këtë vendim, paragrafit 3, nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka fshehur dhe evidentuar në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose përdorim të tij, në përputhje me paragrafin 5, nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

## **VI. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në provat që disponon për vlerësimin e pasurisë, vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme vendosi që subjektit të rivlerësimit, znj. Marsela Balili, gjyqtare në Gjykatën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Shkalla e Parë Tiranë, t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neneve Ç, D, dhe Ë, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, si dhe të pikës 3, nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Marsela Balili, gjyqtare në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 17.1.2020.

## **KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Pamela QIRKO**  
**Kryesuese**

**Etleda ÇIFTJA**  
**Relatore**

**Xhensila PINE**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Olsida Goxhaj*

